Intervistë ekskluzive

'SHQIPËRIA, DESHËN S'DESHËN TRADHTARËT, DO TË BËHET!'

- Afrim Morina -

Afrim Morina është emër i njohur edhe në letrat shqipe e, edhe në politikën shqiptare. Është atdhetar, ngase rrjedh prej një familjeje atdhetarësh të devotshëm. Është veprimtar, sepse, veprimin për atdhe e komb e pati detyrë parësore prej të gjitha detyrave që shtroi e kërkoi koha e tij dhe e brezit të tij, sepse, e kishte amanet prej të parëve. Kur shqiptarët në trojet e tyre të pushtuara kishin vetëm dy rrugë për t'i zgjedhur: Rrugën e Titos dhe të titizmit e të shqiptaro-titizmit antishqiptar, atë të "bashkim-vëllazërimit" me shkie; apo, atë

të Enver Hoxhës e të Shqipërisë, Afrimi u rreshtua aty, ku, zakonisht, rreshtuan të gjithë shqiptarët që e ndiejnë veten shqiptarë në trojet etnike shqiptare, të pushtuara nga ish-Jugosllavia e Serbia, nga Mali i Zi e Bullgaria, e, edhe të Çamërisë nga Greqia. Ai, zgjodhi rrugën e Enver Hoxhës dhe të Shqipërisë së shqiptarëve, paravrësisht se ai rreshtim i kushtoi shumë shtrenjtë: me përndjekje, keqtrajtime, burgosje të njëpasnjëshme, siç u kushtoi edhe shqiptarëve të tjerë si ai. Por, Afrimi, dallon shumë prej të burgosurve të tjerë politikë shqiptarë dhe, sidomos, prej kategorisë së të "burgosurve politikë shqiptarë" që kanë kapur majat e "pushtetit", pikërisht, për vendosmërinë e pathyeshmërinë e tij. Për largpamësinë e tij njerëzore, intelektuale, politike, kombëtare e atdhetare. Parimësisë shqiptare, ai, i ka qëndruar gatitur! Thjesht, thënë me një fjalë: Është parimor për çdo kohë, i gatshëm për ta thënë të vërtetën kudo, kur e kërkon njerëzorja dhe kombëtarja.

Këtë intervistë po e organizojmë dhe po e bëjmë në 65-Vjetorin e tij të lindjes dhe në 42-Vjetorin e krijimtarisë së tij në fusha të ndryshme të artit politik e letrar, vjershëtor e prozator. Multidimensionaliteti i tij krijues shtrihet në shumë fusha të kulturës e të letrave tona shqiptare: në politikë, në letërsi, në prozë, poezi e dramaturgji.

Afrim Morina qe në disa lëvizje, si LRBSH, LPRK e FRBK (Fronti i Rezistencës dhe Bashkimit Kombëtar - Organizatë e parë politiko-ushtarake, e pranuar ligjërisht nga Qeveria e Shqipëisë) etj., e, edhe zëvendëskryetar i UNIKOMB-it dhe ushtroi detyrën e kryetarit, në mungesë të profesor Ukshin Hotit. Edhe para se të dilte publike UÇK-ja, e mbështeti atë dhe me daljen publike të saj, lëshoi kushtrimin publik, se **"aty ku vendosen Pikat e UÇK-së, ajo degë, menjëherë, të kalojë në radhët e saj".** Këtë mbështetje

publike, dhe në takime me subjekte politike e qytetarë, e bëri deri në mbarimin e luftës.

Ishte aktiv në drejtimin e luftës për liri e bashkim kombëtar, në jetën e përditshme dhe në "jetën" nëpër burgjet serbomëdha të Jugosllavisë së "painkuadruar" dhe "vetëqeverisëse" të kryesatrapit Tito, ku qëndroi stoikisht, në parimet e tij shqiptare.

Afrim Morina u lind në katundin Reshtan të Therandës, më 12 qershor 1951. Shkollimin fillor dhe të mesëm (Gjimnazin) i kreu në Therandë dhe studio për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Jetoi, punoi e veproi në katundin e tij të lindjes, në Reshtan, në Therandë dhe në Prishtinë. Veprimtaria e tij atdhetare u shtri kudo në trojet e pushtuara e të copëtuara shqiptare nga ish-Jugosllavia, për t'ia bashkuar ato Shqipërisë, Mëmëatëjonës.

Ka botuar këto vepra letrare e publicistike, të cilat kulmuan, në vitin 2015, me një komplet prej mëse18 sosh dhe u përuruan dënjësisht, në Prishtinë, me titullin simbolik **ARKA E KUJTIMEVE**, të cilit komplet veprash, në 2016, iu bashkëngjit edhe libri **"Filloi e mbaroi me Jabllanoviçët",** e, ato janë: **Arka e kujtimeve** (Mendime /Anekdota); **Peshorja** (Poezi), **Dosja e hapur 1, Në emër të pesë kontinenteve** (romane); **Një monodramë dhe një dramë** (Strajca e gabelicës, Familja në perspektivë); **Dy drama** (Shpërthimi i errësirës, Dhoma numër 24); **Gjurmë kohe 1, 2, 3,** 4 (publicistikë); **Të merituarit hyjnë në histori** (Kujtime); **Meditime** (Filozofi politike); **Mohimi** (Analiza); **Emancipimi politik** (publicistikë); **Bëjeni Shqipërinë – Shqipëri!** (intervista të imagjinuara, etj.

Që të mos e lodhim lexuesin e nderuar, fjalën ia kalojmë shokut Afrim Morina, të na thotë atë që ka për të na e thënë në pyetjet tona, për jetën, veprimtarinë, krijimtarinë letrare,

burgosjen, luftën për bashkim kombëtar e liri të popullit shqiptar, për aktualitetin politik në rrethana të "reja".

Pyetje: – Hapësira për ju, shoku Afrim, na e hap horizontin, mundësisht, me një maksimë tënden, që ty të flenë mëse shumti, për kohët që po na mbërthejnë kështu e kësisoji!

Përgjigje: – Në fillim, ju falenderoj për intervistën që bëni, në këta dy përvjetorë!

Është një realitet i hidhur për ne shqiptarët, sepse, një pjesë e kombit ka jetuar në robëri me mijëra vjetë dhe sot te kjo hapësirë kemi mentalitetin e robit dhe vetëm të na flitet me një gjuhë tjetër, ne bindemi, dhe, fatkeqësisht, kuptojmë! Kjo jetë robi na ka përcjellur që nga romakët, e deri te sllavët, me theks të veçantë ajo nën Serbi, njëherë, nën ombrellën e SKS dhe më vonë të Jugosllavisë artificiale. Po të shikohet sot, kemi po të njëjtën ndjenjë të mentalitet të robit, por, tash, duhet të dëgjojmë vetëm anglisht, gjermanisht, frëngjisht, etj., sepse, vetëm ata dinë të mendojnë për ne! Ndërsa, në pjesën tjetër të Adheut, kemi pasur përmbysjen e këtij mentaliteti, që nga viti 1945 e deri në vitin 1990, kur, për gjithçka është menduar e vepruar shqip, deri sa nuk u mundësua, prej "miqve" tanë, për të ardhur në pushtet pinjollët esadistë e zogistë, bashkë me puthadorët e të huajve, që kishin dy porta mbështetëse: Beogradin dhe Athinën, për të shkuar në shtetet e perëndimit dhe tej Atlantikut, duke e vënë në shërbim të tyre gjithë potencialin mendor, fizik dhe monetar, për zhbërjen e Shqipërisë. Operacioni i njohur si 1001, gjatë viteve 1950-1953, nxjerr në pah edhe portën e tretë - Romën. Kur e them këtë, nisem vetëm nga Konferenca e Paqës, në Paris (1945-1947) dhe argumentet historike që dalin prej dosjeve të shteteve pjesëmarrëse në këtë operacion. Kur i përmendi këto porta, kam parasysh që "baballarët" e kombit kishin nisur ta kërkonin shpëtimin përmes këtyre portave, që nga viti 1939,

dhe po rikthimin e tyre nga këto porta, për operacione të ndryshme, madje, me të madhe, në vitet e "demokracisë".

Poqëse e marrim këtë moto për trajtesë të çështjes kombëtare, në kohën e sotme, atëherë, edhe nuk duhet të befasohemi shumë, se, të huajt kanë misionin e vet, qoftë në gjeopolitikë, qoftë në gjeostrategji, por, edhe për pasuritë e pashterrshme të nëntokës shqiptare, lumenjve, fushave, maleve dhe deteve. Misionet investojnë para të shumta, sepse, kanë elaborate për çdo segment te ne, ndërsa, misionarët shqipfolës, ato para i fusin në kuletat e veta dhe tumirin gjithçka, për të qenë borizanë të tyre. Thënë shqip, ata që janë përcaktuar për të mirat tona, madje, edhe për moshën e popullsisë, kohën e masin me sekonda, ndërsa, ne, si kolektivitet, kohën e masim me orë.

Marrë në tërësi, në kohën e sotme, promotorët kombëtarë, duhet ta bartin në supe barrën e lëvizjes kombëtare, sepse, sot, nuk kemi akademi apo akademikë që do të ulen për ta bërë një platformë kombëtare, për ta mbuluar dhe përshpejtuar kohën e njësimit të politikës kombëtare, përkundër zërave prosllavë të ortodoksisë e të politikës antishqiptare, për të na ndarë në dy kombe, dhe, të ecim drejt së ardhmes si komb i dinjitetshëm, dikur.

Pyetje: – Shoku Afrim, mund të na thoni cili është Afrim Morina?

Përgjigje: – Sa për ta plotësuar hyrjen. Kam qenë ndër organizatorët e nxënësve të shkollave të mesme (gjimnazi dhe normalja), në demonstratën e vitit 1968. Jam ndër themeluesit e Grupit letrar **"Rafaell Gasper Sopi",** 1974, në katedrën e fakultetit të "Zhurnalistikës: Diplomaci-Gazetari", themeluesi i grupit letrar **"Elena Gjika"** në Therandë, në vitin 1975 dhe kryetar i saj deri në maj të vitit 1981. Aty kam zhvilluar aktivitet letrar, interpret e regjisor, e, në vitin 1980, kam shfaqur dramën time **"Horizonte të reja"** dhe, në vitin 1995,

e kam ekranizuar dramën e Ismet Rashit, "**Tokë e përgjakur"**.

Kam udhëhequr aksionin e pajtimit të gjaqeve në Therandë, deri kur jam burgosur, më datën 16. 12. 1991. Kam qenë nënkryetar i KMDLNJ-së për një vit dhe sekretar i shkollës "Flamuri i Arbrit", në vendlindje.

Menjëherë pas luftës, e kam krijuar Shoqatëm e të pagjeturve dhe kam arritur, përmes rregullores, t'i bashkojë të gjitha shoqatat simotra, që, sot, veprojnë përmes një Këshilli Koordinues. Gjithashtu, jam edhe ndër themeluesit e Sindikatës së Shërbyesve Civilë dhe kryetar i parë i saj.

Kam filluar me publikime në vitin 1974 dhe në vitin 1976 më është marrë e drejta e publikimeve nga "Zëri i Rinisë"; "Rilindja" dhe revistat e kohës. Që nga fillimi i publikimeve, më kanë mbetur disa poezi dhe romani "Në emër të pesë kontinenteve", të tjerat janë të viteve të nëntëdhjeta e këtej.

Jam burgosur më 02. 4. 1974; 26. 5. 1981; 09. 5. 1990 dhe 16. 12. 1991, gjithsej, i kam mbajtur gjashtë vite e gjysmë burg.

Pas luftës, jam tërhequr nga strukturat partiake të UNIKOMB-it, me moton "**Po nëpërkëmbën njerëzit që e kanë bërë historinë".** Partia, të cilën e udhëhiqja, nuk kishte mundësi ta bënte këtë, por, këtë filluan ta bënin të tjerat. Që nga atëherë, merrem me analiza politike e shkrime letrare dhe nuk i takoj asnjë subjekti politik.

Gjatë gjithë kohës, si i burgosur dhe i papunë, ndoshta, nuk do të isha ky që jam, pa mbështetjen e prindërve, vëllezërve, motrave, nipave dhe gruas, bashkë me fëmijët e mi.

Pyetje: – Na thuaj diç më shumë për poezinë, monodramat, dramat, publicistikën. Ç'porosi përçoni te lexuesit shqiptarë, përmes tyre?

Përgjigje: – Me poezi kam filluar të merrem që në shkollë të mesme, ku, edhe i lexoja nëpër orë letrare. Publikimin e parë e kam pasur më 1974. Kjo më dha kurajo dhe fillova të shkruaj edhe më tepër. Në vitin 1975, fillova të merrem me gazetari, fillimisht në "Zëri i Rinisë". Me drama dhe prozë kam filluar të merrem po nga mesi i atij viti. Jam marrë edhe me hulumtime toponomastike, me histori ilegale, duke mbledhur shënime nëpër fshatra të ndryshme, në hapësirën e Shqipërisë së robëruar. Mbi dymijë (2000) faqe të shkruara me dorë e makinë, ose më janë marrë gjatë bastisjeve, ose më janë djegur gjatë luftës. Më është zhdukur **"Ploja e Tivarit",** që, asnjëri deri më sot nuk e thotë të vërtetën. Këtë e them me bindje, duke u nisur nga anketat e bëra, të rreth dyzet pjesëmarrësve, nga komuna të ndryshme (1974), e, që, i trajtoj pak në romanin "**Dosja e hapur 1"**. Kam shkruar edhe shtatë drama e dy radiodrama, dy romane, një poemë, një analizë studimore **"Familjet e mëdha, si rezultat i marrdhënieve ekonomike"** (1976), monografinë **"Liridashësit"** (1986-1991, për therandasit) dhe një përmbledhje poezishë. Mjerisht, që, këto janë zhdukur dhe nuk mund të riprodhohen më.

Nga vetë titujt e të gjitha veprave del porosia. Çrrënjosja e robërisë përmes organizimit dhe propagandës së shëndoshë kombëtare, emancipimit kombëtar të brezave; bërja e platformës kombëtare, mbytja e frikës, mbytja e lakmisë për pushtet e pasuri, kthimi i dinjitetit kombëtar, por, e gjithë kjo nuk bëhet, pa këtë porosi:

"Vetëm unë, askund. Vetëm ti, si anjë. Vetëm ai, as te skaji. Ne të tre, përnjëmend, plot shend, me guxim, për atdheun tim, japim kushtrim". (**Vetëm**, shtator 1975). Kjo, sepse, **"Duket se, do të jem më i rëndë."** (**Peshorja**, 1974).

Pyetje: – Jeni njeri i njohur i letrave shqipe dhe i politikës, veprimtar i njohur i çështjes kombëtare, si ndodhi që të shkojë kështu huq e gjithë puna, mundi dhe gjaku i dëshmorëve të kombit në luftën tonë për bashkim kombëtar?

Përgjigje: – Lufta për bashkim i ka rrënjët thellë në histori. Por, ne, këtë duhet marrë si trajtesë vetëm nga koha e titizmit deri sot, pra, periudhën 71-Vjeçare. Nëse i referohemi motos, lufta është vazhdim i politikës, del se ne jemi munduar me politikë ta bindim kombin tonë, pushtuesin, ndërkombëtarët, se jemi të robëruar, por politika kuislinge, shtypi i verdhë dhe kolona e pestë, janë ato që kanë bërë që zëri i ynë liridashës e atdhebërës të mos dëgjohet larg, por, të mbetët përbrenda familjeve e miqësisë, që, here-herë, edhe ato kanë heshtur, ose janë ushqyer nga këto elemente që i theksova më lart, qoftë përmes përjashtimit në punë e studime dhe leçitjes, si forma më e vrazhdë e ndëshkimit. M'u duk sikur më shikove ndryshe, shoku Tafil, kur e mora këtë periudhë 71 vjeçare? Të dy e dimë këtë, se ende nuk jemi të shliruar, kur rreth 30% e territorit tonë në këtë Kosovë administrative, kontrollohet nga serbët dhe tash bëhet luftë edhe për pasuritë tona, mbi e nën tokë, me ndihmën e Brukselit. Të kthehemi te pyetja që ma keni parashtruar. Vetëm në vitin 1968 filloi të dëgjohet zëri i ynë në publik. Ky zë u dëgjua edhe në vitin 1981 dhe gjithë periudhën deri në vitin 1990. Patëm një "heshtje" kur, në vitin 1992, mediat raportuan për një process gjyqësor, dënimin e themeluesve të ushtrisë, duke prezentuar uniformat dhe armët. Përsëri heshtje, derisa në vitin 1995, rifilloi të dëgjohet zëri i ynë, por, tash, përmes grykës së pushkës. Këto momente të dëgjimit të zërit tonë, në gjithë hapësirën kombëtare dhe ndërkombëtare, që arritën piemontin e politikës botërore, edhe pse, u munduan t'i heshtnin armiqtë dhe argatët e tyre, nuk arritën. Këto

filluan ta zgjojnë ndërgjegjen kombëtare dhe ndërkombëtare, por, armiku, gjithnjë e më tepër i forconte mjetet shtypëse dhe kursin e prezentimit të çshtjes shqiptare, sikurse po na ndodhë edhe sot.

Derisa jemi ende të robëruar e copëtuar kështu, si mund të mendojmë shqip për dëshmorët dhe veteranët e rezistencës kombëtare, kategori për të cilën as që bëhet fjalë! Larot kanë bërë që gjaku i dëshmorëve dhe invalidëve të duket se ka shkuar huq, mirëpo, realiteti është tjetër, se mu ai gjak do ta mobilizojë gjeneratën pasuese, për ta vu drejtësinë në vend. Ne të dy e dimë se, kohëve të fundit, ka filluar me të madhe të shtrohet pyetja, çfarë të bëjmë? Kësaj, jemi ne, shqiptarët, që duhet dhënë përgjigjen, duke kontribuar në zgjimin e kombit nga letargjia, për ta arritur, të paktën e 20%, pastaj, liria do ta marrë rrugën e vet. Por, gjithë kjo energji duhet kanalizuar mirë dhe drejt, që të jetë i bashkuar potenciali mendor, fizik e ekonomik i kombit. Këtë, mund ta bëjmë me një çasje të drejtë dhe të guximshme, për të cilën edhe kemi biseduar, përmes letërkëmbimit, në vitin 2011. Shumë grupime politike e ushtarake kanë dalë në skenë viteve të fundit, por, misioni i themeluesve ka qenë vetëm për t'i vënë në pah të "rebeluarit", që, pastaj, të jetë më lehtë të përcillen.

Derisa nuk fitohet liria, dëshmorët kanë për t'u trajtuar me tesera partishë, kur dihet se mu përmes taserash partiake është dëmtuar mëse shumti lufta shlirimtare, edhe gjatë viteve 1997/99.

Pyetje: – Shqetësimet tuaja kombëtare e atdhetare, kapen në çdo vepër letrare, qoftë në poezi, qoftë në prozë, në drama, monodrama e publicistikë, përgjithësisht, ku është burimi i tyre?

Përgjigje: – Burimi?! Rruga nëpër të cilën kaloi kombi i im, nëpër të njëjtën rrugë kanë kaluar edhe familjet patriotike, që ia kanë vu gjoksin përpara armikut. Thënë ushtarakisht,

janë munduar të jenë parzmore, se vetëm me parzmore mund të mbrohet jeta dhe,atëherë, atdheu ka këtë kuptim-jetën! Nëpër cilën rrugë ka kaluar kombi gjatë këtyre viteve, ka kaluar familja ime, unë dhe shumë familje në Shqipërinë e robëruar. Gjithë veprimtaria e ime letrare dhe publicistike materien e ka marrë mu nëpër vitet e kaluara nëpër ecejake luftash e zjarri për Atdhe e Liri, nëpër rëniet e ngritjet e kombit tim dhe luftat e pamëshirshme, nëpër kohë, të dy taborreve: atij kombëtar dhe të armiqve shqipfolës, por, që, fatkeqësisht, asnjëherë nuk kemi arritur ta mposhtim këtë të dytin dhe mu për këtë jemi ku jemi. Sepse, i dyti ka pasur për "kapital" "intelektualët" deri në thirrje akademike, ka pasur për kapital edhe një kategori të ish të burgosurve politikë, e, që, viteve nëntëdhjeta e këtej, shumica janë drejtuar andej kah ishte grazhdi plot, ka pasur për kapital propagandën e verdhë, ka pasur për kapital kolonën e pestë, ka pasur për kapital edhe ndihmën e miqve tanë, dhe, në hapësirën tonë kombëtare i ngulën tri thika: në Prishinë, Ibrahim Rugovën, në Tiranë, Sali Berishën dhe në Shkup, Arbër Xhaferin. Këta kishin për mision ta shthurnin levizjen kombëtare, që, në vitin 1990, kishte prekur çdo cep të atdheut, prandaj, vepruan si në mitologji, shpërqëndrimin e rrugëtimit të korrilave.

Kryesorja është, se edhe ti dhe unë e shumë shokë tanë, jemi të edukuar në shkollën kombëtare të Tiranës dhe jo në ato të Beogradit, Athinës dhe të Stambollit, sepse, edhe familjet tona kanë kontribuar që të marrim mësimimet në atë shkollë dhe i gjithë brumi i tajtuar në prozë, poezi, dramë e publicistikë është marrë nga qëndresa e kombit tim, por, edhe fillozofia politike që e trajektoj, brumin e ka mu aty.

Pyetje: – Kujt i takon barra e përgjegjësisë morale e penale, për situatën që mbretëron e na ka mbërthyer keqas tash e dy dekada, pas luftës së lavdishme të UÇK-së?

Përgjigje: – Përgjegjësia morale na takon të gjithëve, por, në radhë të parë, ish të burgosurve politikë dhe LPRK-së. Këtyre dyjave, sepse, janë të parat që e harruan misionin e tyre dhe pranuan, madje, edhe e forcuan programin e "autonomisë substanciale", në krye me Rugovën. Këta filluan të veprojnë kundër të kaluarës së vet, dhe, në pah doli qëllimi për të qenë figura publike, të respektuara nga të huajt, në emër të një lëvizjeje që nuk ka ekzistuar kurrë dhe krijuan taborrin e ndarjes, tash, përbrenda kombit, që dikur ishte i theksuar kundër armikut. Kjo kategori u mundësoi misioneve të huaja për ta topitur tehun e revolucionit, që, në fundvitet e tetëdhjeta dhe në vitin 1990 u alarmua e gjithë bashkësia ndërkombëtare për masivizimin e demonstratave edhe nëpër fshatra. Evropa dhe SHBA-të mundoheshin ta mbanin në këmbë të sëmurën e Ballkanit, me çdo kusht, dhe, kjo kategori ishte e vetmja që mund ta kryente punën e misioneve në cilësinë e misionarëve. Sot, këta i kemi emra të harruar në lëvizjen kombëtare, sot, kur kanë mundur për ta bartur gjithë rezistencën mbi shpatulla dhe sot do të kishim folur për të merituarit si dëshmorë, invalidë, veteranë të UÇK-së, por, edhe për dëshmorët, invalidët dhe veteranët e lëvizjes kombëtare.

LPRK-ja, në fillim e tumiri këtë lëvizje, u bë argat i saj, ishte prijatare për regjistrimin e anëtarëve të LDK-së, sipas marrëveshjes që ishte arritur në mes Rugovës dhe Bejadin Hallaçit. Rugovizmi, e shtriu shtratin e vet në gjithë territoret e Kosovës, madje, filloi edhe ta koordinojë politikën me Riza Halimin për Luginën e Preshevës dhe e dërgoi Arbër Xhaferin për misionar në Maqedoni.

Këto dy kategori, sidomos, e para, ua mundësuan zbatimet e misioneve që kishin "miqtë" tanë për Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, pasojat e të cilave i patëm para, gjatë dhe pas lufte, e, po vijojnë deri në ditët e sotme.

Ndërsa, përgjegjësia penale kapë një rreth pak më të ngushtë. Ai rreth shkon në strukturat politike, si kreatore dhe zbatuese të misioneve të huaja, të artikuluara dhe elaboruara në Beograd, nga ASHAS dhe nga kisha ortodokse sllave. Këtu, dalin emra të përveçëm, që nga themelimi LDK-së me punktet e saj, për të krijuar "pluralizëm" politik, duke i vënë në shënjestër të burgosjeve e përndjekjeve, të gjithë ata që mundoheshin ta bënin zgjimin kombëtar, FRBK-në, LKÇK-në, LPK-në dhe UNIKOMB-in. Kjo kulmoi me burgosjen dhe mosinteresimin e zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit.

Ndërsa, përgjegjësi penale, për paslufte, duhet kërkuar te ata të cilët ishin bartës zyrtarë të luftës, të cilët, në emër të gjakut të dëshmorëve, krijuan karriera politike, duke e keqpërdorë epokën më të lavdishme të kombit në historinë moderne, për të zhvatur gjithçka që u ka ardhur ndoresh. Sikur këta të kishin qenë në nivel detyre edhe pas luftës, të parët - as që kishin guxuar ta çelnin gojën. Këta mundësuan ta kemi Isa Mustafën në krye të Qeverisë, i cili zbaton detyrat që i ka marrë nga KOS-i dhe, në vazhdimësi, amnistuan gjithë sorrollopin, deri edhe në cilësinë e UDB-ashëve, madje, edhe "Rojet e Urës" (elitën paramilitare serbe), për t'i pozicionuar edhe deputetë, ministra, zëvendësministra, kryetarë bordesh e drejtorë institucionesh, në njërën anë, ndërsa, në anën tjetër, i injoruan njerëzit që e kanë bërë historinë.

Pyetje: – Sigurisht, dikush mban përgjegjësi, por, duket se tek ne shqiptarët, faji është gjithmonë jetim? Mos na mësoi kështu robëria e gjatë dhe servilët që i shërbyen çdo robërie?!

Përgjigje: – E thashë edhe më lart se kush janë përgjegjësit, një pjesë bukur e mirë, kanë për të më sharë, sepse, ua kam "cenuar ndërgjegjen". Kjo është ikje nga përgjegjësia, flas për ata që ia kanë bërë argatin falas së keqës, sepse, votuesi nuk ka asnjë përfitim, por, shtypi i verdhë ia

përtypë sipas oreksit që ka akëcili votues, për akëcilin lider, pushtetar e kuvendar. Ne, nuk duhet t'i amnistojmë, sepse, kanë shkuar aq larg, sa, jemi në zgripc të vendimmarrjes, për të ecur përpara në frymën e gjakut të derdhur me shekuj dhe betimit të dhënë, apo, për ta pranuar shtratin e Prokrustit. Duhet pasur guxim intelektual e kombëtar, për t'ua drejtuar gishtin larove e honxhobonxhove, siç kemi bërë edhe ne dy me disa shokë, gjatë gjithë kësaj periudhe, për të cilën ndërlidhen këto dy pyetje. Ky guxim mungon, mu për këtë ende i kemi të paprekshëm, prandaj, duhet vepruar për t'i vënë para përgjegjësisë historike.

Pyetje: – Si ndodhi që numri i "veteranëve" të UÇK-së të shkojë aq lart? Cilat, sipas jush, ishin kriteret e marrjes së statusit veteran apo luftëtar i UÇK-së? Apo, gjithçka po i lehet stihisë, akraballëkut, farefisnisë e fiseve të bajraktarëve e të bajraktarizmit politik e intelektual provincial?

Përgjigje: – Departamenti i vlerave të luftës ka filluar së funksionuari në Janar të vitit 2004. Ky Departament, ka qenë dashtë t'i marrë regjistrat nga Komandanti i UÇK-së dhe nga Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Kosovës, si organe që kanë disponuar me regjistra bazë dhe për këtë ka pasur shënimet shumë të sakta. Kjo vonesë e shkaktuar qëllimisht, deri në vitin **2015**, ka qenë më tepër për t'i parë rrjedhat e deriatëhershme, për të krijuar mundësi manipulimi me shifra, të të gjitha kategorive.

E para, koha prej kur llogaritet për të qenë veteran, është e jashtëligjshme. E jashtëligjshme, sepse, bie ndesh me vetë datën e formimit të UÇK-së, që ka qenë dashtë të jetë Gushti i vitit 1994. Marrja e datës, 31 Dhjetori i vitit 1991, jep për të kuptuar vetëm veteranët e rezistencës kombëtare, kategori e cila nuk njihet me asnjë ligj. Kjo datë është marrë, vetëm për ta mundësuar shpëlarjen e të kaluarës, se, ka qenë dashtë të

rehabilitohen shumë eksponentë të LDK-së, që kanë kaluar në struktura politike e ushtarake të UÇK-së, në momentin e shtrirjes së saj në terren, gjoja se ata kanë ndihmuar dhe kanë vepruar në një mekanizëm ushtarak "ekzistues". Këtu kemi edhe një lojë, që, në emër të PDK-së, e ka luajtur Jakup Krasniqi me Ismet Beqirin e LDK-së, që u ka konvenuar të dyja palëve, përfshirjen e kësaj periudhe kohore. Edhe publikisht e kam thënë, për ta plotësuar kohën e veprimit ushtarak, në Shqipërinë e robëruar, për periudhën e 31.12.1991, dëshmitë mund të merren në dy makanizma ushtarakë të kohës FRBK dhe më vonë në LKÇK, deri në themelimin e UÇK-së, sepse, kjo e fundit nuk ka ekzistuar.

Titullin e veteranit mund ta gëzojnë vetëm ata të cilët kanë qenë në struktura politike e ushtarake, që nga themelimi e deri në mbarim të luftës. Ndërsa, për ushtarët kjo kohë duhet llogaritur nga momenti i armatosjes deri në mbarimin e luftës, e jo siç ka ndodhur, këtu, te ne. E, për ta mundësuar lojën për këtë mishmash, është emëruar Agim Çeku si kryetar, personi që nuk ka pasur të drejtë statutare e ligjore për ta udhëhequr, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, komisionin e krijuar me baraspeshë, pra, edhe nga ata të cilët e kanë quajtur UÇK-në si kreaturë të Millosheviqit, jep për të kuptuar, se, është lënë hapësirë për të pamerituarit, që të përfshihen në këto pesë kategori.

Duke u shkelur këto dy parime thelbësore, situatën e ka pasur në dorë farefisi, dajallarët, miqësia, partia dhe paraja. Njoh njerëz që e kanë plotësuar kriterin, për çdo kategori dhe nuk janë marrë parasysh, por, edhe të tillë që nuk kanë qenë fare në rrjedha të ngjarjeve, madje, edhe që e kanë sharë e mallkuar UÇK-së, e, sot, janë veteranë, të plagosur, e, madje, edhe dëshmorë.

Pyetje: – Po kontributi i atyre atdhetarëve e shqiptarëve që nuk kanë qenë anëtarë "par(t)ishë" e

“Lëvizjesh”, po kanë qenë pjesë aktive në të gjitha proceset dhe zhvillimet kombëtare, ku do mbetet dhe a do t’u njihet ndonjëherë atyre njerëzve? Cila histori do t’ua njohë kontributin dhe meritat?

Përgjigje: – **K**ur kam folur për veteranët e rezistencës kombëtare, mendoj se i kam përfshirë të gjithë ata të cilët kanë vepruar e veprojnë për çështje kombëtare. Nuk do të thotë, se të qenit në ndonjë lëvizje apo subjekt politik, u jep të drejtën të krekosen, për punën e bërë, në të mirën e atdheut. UÇK-ja është dëmtuar më tepër për shkak të teserave të partisë, sepse, krijohet disproporcioni në mes të shtrirjes gjeografike me atë të komandimit, si shprehje aritmetike.

Veprimtaria matet me veprat e bëra, me shkrime e analiza, për situatat në të cilat gjindej dje, e sot, kombi. Matet edhe me vepra letrare, se si e trajton çështjen kombëtare, çfarë mesazhi dërgon te lexuesit dhe sa arrin ta mobilizojë masën. Veprat janë ato që i masin veprimtarët. Unë, sot, nuk kam asnjë teserë partie, mirëpo, puna ime, këto vite të pasluftës, do të dëshmojë, i kam shërbyer kombit apo jo. Unë, nuk bëj vija ndarëse të shqiptarëve në këtë mënyrë, por, ndarja ekziston në punën e akëcilit qytetar. Edhe partitë ekzistuese, në territoret shqiptare, kanë në gjiun e vet burra e gra të denja për çështjen kombëtare, por, ato i ka mundur e keqja, përmes programeve. Besoj, se, një ditë, do ta marrin guximin dhe t’u thonë lamtumirë programeve qytetare dhe do të rreshtohen për kauzën e drejtë kombëtare. Ky, fillimisht, do të jetë 20%, për të hapëruar, pastaj, drejt synimit historik. Pikërisht, te këta, unë, kërkoj rreshtimin në tëbanin kombëtar, për ta drejtuar çështjen drejt dhe guximshëm.

Nuk besoj se ka tjetër barometër për ta matur më mirë punën e akëcilit veprimtar, sepse, në fund të fundit, ne, përmes mësimit dhe faktografisë së historisë, kemi nxjerrë

përfundime për figura kombëtare, edhe pse hitoria, shumë herë, është treguar njerkë.

Pyetje: – Pse po na përsëritet dhe pse po na hakmerret historia kaq keq? Cilët janë shkaktarët?

Përgjigje: – Shumë faktorë bëjnë pjesë në përsëritje dhe hakmarrje nga historia. Kjo merret, se, si e vlerësojmë ne një epokë të historinë dhe në çfarë parametrash e bëjmë vlerësimin, sepse, të shumtën e herës historianë dhe shkrimtarë mendojnë se historia duhet shkruar sipas apetiteve politike, lideriste, familjare, karrieriste, farefisnore, të parave, etj. Historia është ajo që ka ndodhur dhe ajo që kemi pasur dëshirë të ketë ndodhur dhe do të ndodhë në vijimësi. Shembuj të tillë, sot, ka përplot, në histori, kur zhveftësohen figurat e mëdha kombëtare dhe në vend të tyre vlerësohen figurat bashkëpunëtore ose edhe më e keqja, tradhëtare, që, në këtë kohën tone "demokratike", kemi shembuj të shumtë. Të paktën, ne, shqiptarët, kemi përse të flasim dhe si duhet vlerësuar historinë, sepse, nuk ka përfunduar asnjë dhjetëvjetësh pa pasur zhvillime politike dhe në këto zhvillime kemi pasur gjithnjë dy taborre, dhe, nuk ka mundësi që veprimtarët kombëtarë të zëvendësohen me taborrin tjetër, që i ka mundësuar armikut ta kryejë misionin e vet pushtues. Kjo ka ndodhur edhe në LDB, ku, në të njëjtën betejë të vitit 1944, në një front vriten dy veta. Ai që ishte në radhët e partizanëve kishte titullin e dëshmorit, dhe, Sali Berisha, në vitin 1995, e shpallë dëshmor edhe ushtarin tjetër, që e kishte uniformën e nazizmit!? Kur ka pasur moral ta bëjë një veprim të tillë, që, në dukje, është shumë i vogël, paramendo se sa ka vepruar për kohët dhe frontet e ndara. Ai, për ta rehabilituar Esadin, kritikon Nolin, do të thotë kritikon elitën kombëtare që përndoqi, vrau dhe syrgjynosi Zogu. E inicoi edhe lojën për t'ia ndërruar emrin Universitetit të Vlorës, që mbante atë të Ismail Qemalit, që, në përvjetorin e pavarësisë të mos

figuronte emri i Tij. Pastaj, kemi shembullin konkret, në një fshat të Besianës, një shkollë që mbante emrin e Azem Bejtës, sepse, aty i ishte dhënë bekimi për t'i udhëhequr çetat kaçake nga Hasan Prishtina dhe figurat e tjera kombëtare të kohës, i heqet emri dhe e zëvendësojnë me emrin e gjyshit (hoxhë) të Fatmir Sejdiu (atëherë, President). Kjo, po bëhet edhe me kërkesa politike nga jashtë. Shembulli tjetër, Presidenti dhe Kryeministri i Turqisë, kanë kërkuar që të pastrohet fjalori në historinë tonë, sepse, ata nuk kanë qenë pushtues(!), nuk na kanë djegur e vrarë, nuk na i kanë therrur edhe me bajoneta nënat dhe gratë shtazëna e nuk na i kanë prerë fëmijët në djepa, sipas urdhërit të Mehmet Pushtuesit II, për të mos u lejuar shumimi i farës së djallit, nuk na i kanë marrë të mirat materiale, nuk na i kanë marrë djalërinë për nizamë nëpër skajet e perandorisë së tyre, se nuk është e vërtetë se na kanë penguar në shkollim, etj. gjatë periudhës 500-Vjeçare. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja e tumiri këtë, thua se Ai ishte personi që mund të vendosë se si të shkruhet historia. Për çudi, thirrjes së Qeverisë turke, me entuziazëm, i përgjigjen edhe disa palohistorianë, që kanë bërë disa ndërhyrje.

Ne, edhe sot, nuk i respektojmë ndodhitë historike të këtyre njëzeteshtatë vjetëve. Shikoni çfarë u ofrojnë historianët mjeranë fëmijëve tanë për historinë. Secili, për t'u bindur me realitetin, mund ta shohë: sa hapësirë ka rugovizmi, UNMIK-u dhe UÇK-ja?!!!

Derisa ne i bëjmë gjithë këto lojëra me histrorinë tonë, një material shumë i thukët dhe i yshtur nga misionet e huaja, krijon edhe taborrin mbrojtës të vlerave historike. Nëse shkon kështu, siç ndodhi me kërkesën turke, me Malin e Zi, Maqedoninë dhe nesër me Serbinë, djemtë dhe vajzat shqiptare nuk do të lejojnë të përdhoset historia kombëtare

dhe do të merren më me ngulm me këtë problem, për të mos na u përsëritur dhe për të mos na u hakmarrë historia

Shqiptarët, do t'i rreken më me seriozitet bashkimit dhe, në rrugëtim e sipër të saj, edhe do ta bëjnë pastrimin e historisë!

Pyetje: – Mos është shkaktare përzgjedhja negative e kuadrove për një shekull rresht, që ka bërë Serbia e Jugosllavia pushtuese, e, më parë edhe Porta e Lartë, ngase, ne, shqiptarët, qemë dhe jemi ende nën pushtim të trefishtë, serbo-jugosllav, shqiptaro-titist dhe ndërkombëtar? Cila është e vërteta?

Përgjegje: – Më herët e kam përmendur mentalitetin e robit dhe shkollat e huaja. Nisur nga këto dy elemente, del përkufizimi i Juaj, shoku Tafil, për robërinë që ekziston jashtë Shqipërisë londineze. Shkollat e huaja, e kanë rrënjosur edhe mentalitetin e robit. Jemi dëshmitarë, kur në fillim të luftës dëgjonim zëra të çjerrë, që mundoheshin t'i frikësonin shqiptarët dhe pjesëtarët e UÇK-së, "se Serbia, nga Nishi, për dy orë, mund të na bëjë shkrumb e hi!". Poqëse i referohemi kësaj motoje, shumë lehtë mund të përfundojmë, me logjikë të shëndoshë, se këtë propagandë, në kokat e lidershipit, e ka rrënjosur, në këtë pjesë të atdheut, përmes shkollës së saj të Prishtinës, shkolla e Beogradit, por, edhe te një pjesë e lidershipit në Shqipërinë londineze, e ka kultivuar po të njëjtën gjë, përmes shkollarëve të Athinës e të Prishtinës servile. Këtë fenomen e kemi pasur që nga demonstratat e vitit 1968. Mirëpo, u doli e kundërta.

Sot, në këtë kanë ndërhyrë edhe shkollat sllave e pansllave, për të na e humbur dinjitetin kombëtar dhe për ta fshirë çdo gjurmë shqiptare nga trupi dhe shpirti i ynë, për të na paraqitur të vegjël e të padijshëm, për të na bërë të dukemi se nuk kemi forcë ekonomike, për të na paraqitur se te ne dominon feja e jo kombi dhe këtë mentalitet të asaj politike e

ka pranuar lidershipi, në gjithë këtë hapësirë kombëtare. Ne, nuk jemi duke e vlerësuar veten dhe potencialin tonë kombëtar, si vlerën e vetme reale që e kemi, atëherë, si do të na vlerësojnë të tjerët? Misioni i armikut është: Përçaj e sundo! Me ndihmën e "miqve" ndërkombëtarë, ia kanë arritur qëllimit. Në disa përgjigje, më lart, e kam thënë këtë. Sepse, ne jemi vetëmohues të historisë dhe misionarët e tipit të Halil Matoshit, të Migjen Kelmendit dhe të Nexhmedin Spahiut, etj., dalin dhe e mbrojnë shkollën e Beogradit, me "filozofinë" për "kombin Kosovar" e "shtetësinë kosovare". Shikuar më thellë, kësaj i ka paraprirë edhe Rugova, me pacifizmin e tij, me flamurin e prezentuar me qen sharri, me t'lyem buallice e me Darkën e Lamës(!), që nuk është aspak dardan, sepse, ai dardan valon në institucionet e Maqedonisë, i ka yshtur pinjollët shesheliane për ta elaboruar "kombin Kosovar". Kohëve të fundit, janë dëgjuar edhe zëra histerikë, si ai i Mehmet Krajës, në emër të ASHAK, se, Kosova, po pushtohet përmes kulturës nga Shqipëria. Ai, më me për qejf e ka të jetë i pushtuar nga Serbia, Mali i Zi e Maqedonia, sesa ta kemi një kulturë kombëtare, e cila do të na prezentonte në botën e qytetëruar si komb i lashtë dhe i dinjitetshëm. Në kurthin e ASHAK ka rënë edhe politika e Kosovës, që e bën një hap më tej, kur kërkohet që Edi Rama të mos e mbrojë Kosovën, se ajo ka gardianët e vet SHBA-në dhe Evropën! Mjerimi akademik e politik, është rezultat i gjendjes në të cilën gjindemi, të pushtuar trefish!

Pyetje: – Në kohën kur po e bëjmë këtë intervistë, ndodhi edhe riciklimi "patriotik" e "shqiptar" i radhës(!): Dënimi i "Grupit të Drenicës" dhe një luftë tjetër "parimore" e "mediale", madje, edhe zyrtare, kundër kryeministrit shqiptar Edi Rama, për fjalimin e tij dhe qëndrimin drejt, në krah të Kosovës shqiptare,

në Beograd, si mund të vlerësohen e kualifikohen veprime të tilla antishqiptare?

Përgjigje: – Dhënia e dënimit të formës së prerë, për rastin e "Grupit të Drenicës" është pritur dhe kjo nuk ka qenë dashtë të na befasojë, aq më tepër, t'i befasojë ata të cilët edhe ia kanë dhënë mandatin për gjykim, një gjykate që nuk ta njeh luftën dhe shtetin. Në këtë formë, i kanë lënë pa mbrojtje të dinjitetshme dhe pa u thelluar, se në këtë proces po dënohet lufta shlirimtare, pa marrë parasysh kush janë protagonistët, aq më tepër, kur kemi të bëjmë me Komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimin. Kemi pasur procese të shumta gjyqësore gjatë historisë, atëherë kur e ka ngritur zërin populli, gjykimet kanë qenë më të ulta, ndoshta, edhe janë liruar (rasti i Avni Rustemit, në Paris) dhe e kundërta, atëherë kur qeveritarët kanë tumirë politikën e pushtuesit, dënimet kanë qenë më të larta (rasti "Drenica një dhe dy"). Në këtë rast, zëri i popullit nuk është dëgjuar, zëri i Shoqatave të dala nga lufta nuk është dëgjuar dhe heshtja e institucioneve ka qenë e skajshme, çfarë mund të kemi pritur, lirimin, jo, kurrë!!!

Ky proces gjyqësor, që pas shumë kohësh, pothuaj u përmbyll, nuk ishte vetëm lojë e EULEX-it, por edhe e analistëve oborrtarë, të cilët, paraprakisht, e kishin shpallë dënimin, sikurse në sistemin amerikan: Janë fajtorë! E, lartësia e dënimit është çështje tjetër, me rëndësi se këta e përgatitën opinionin dhe gjykatën, të parën për të heshtur, e të dytën, të mos ketë frikë për dhënien e dënimit.

Analistë oborrtarë i kam quajtur gjithëherë, që kur kam filluar të merrem me publicistikë, sepse, këta janë misionarë të (para)paguar të klaneve dhe, tërthorazi, varësisht nga animi i klanit, anojnë edhe këta dhe përfundimi është, ujin e dërgojnë në mullirin e armikut të vjetër dhe të ri, kundër shlirimtarëve e kundër shqiptarëve.

Kryeministri i Shqipërisë londineze, z. Edi Rama, e ka kryer detyrën që i ka dhënë Kushtetuta dhe nuk ka bërë asgjë më tepër. Sharlatanët politikë, gazetarë të orientimeve kundërshqiptare, qoftë të shkollës së Beogradit, Athinës apo edhe të Brukselit, u munduan që, nga këndi i argatëve të misioneve të huaja, të na e prezentonin realitetin e ndodhur në Beograd. A ka më shuplakë të madhe diplomatike, që i dha Vuçiçit, kur i tha (prarafrazim): "Nuk mund ta marrësh Trepçën në thes, e, ta sjellësh në Beograd, ajo i takon Kosovës dhe qytetarëve të saj!" dhe këtë në sy të gjithë botës dhe, tash, të interesuarit do të pyesin ku gjindet Trepça? Këtë nuk e kanë parë vetëm ata të mentalitetit të robit, se ai mentalitet nuk është mësuar të dëgjojë shqip, këtë e kam spjeguar në një përgjegje më lart, se, nuk u tha anglisht, për ta pranuar dhe kuptuar më mirë edhe mentaliteti i përgojuesve, se, në këtë cilësi i kemi analistët oborrtarë dhe gazetarët misionarë.

Pyetje: – Lufta e UÇK-së po denigrohet e shantazhohet prej bijve dhe bijave të atyre shqiptaro-titistëve që shantazhuan Luftën e Drenicës dhe i vranë udhëhqësit e saj, Shaban Palluzhën e Mehmet Gradicën dhe i përndoqën për një gjysmë shekulli bashkëluftëtarët e tyre. Si ndodhi kështu, që të mos mësojmë asgjë prej pësimeve?

Përgjigje: – Titizmi ishte filozofi në vete. Nxënësit e asaj filozofie dhe vasalët, janë dy kategori. Por, që të dyja kanë plotësuar njëra-tjetrën, njëra palë me dëshirë dhe tjetra për interesa personale e farefisnore, apo, edhe nga frika. Kategoria e dytë është marrë me shqiptarët nëpër të gjitha kohët. Nisi me Shabanin, i cili, kur e pa se tradhëtia i kishte arritur majat e vrasjeve, ia ktheu pushkën tradhtisë, dhe, është edhe sot në proces të gjahut të shlirimtarëve të luftës shlirimtare. Ky mision ka qenë në vazhdimësi, duke mos zgjedhur mjetet. Sot, e kanë më lehtë të arsyetohen, sesa dje. Sot, flasin në emër të

të drejtave të njeriut, se, kështu e lypë Brukseli. Ata, nuk arrijnë ta kuptojnë nocionin komb, sepse, komb për ta ishte Jugosllavia dikur, e, sot është Kosova. Prandaj, të gjithë duhet punuar e ruajtur këtë, e, jo të ndahet në barrikada, pushtues-shlirimtar, shqiptar-kosovar, shqip-anglisht, patriot e tradhtar, etj. Këta janë misionarë, për t'i zhdukur barrikadimet dhe të marrin sa të duan serbët, maqedonët, malazezët, turqit, e djalli me të birin, atë që i premton Brukseli, sepse, ky është kryeqyteti për këta mjeranë dhe kryeqyteti nuk di të mendojë, siç mendojnë shqiptarët, por siç mendojnë kosovarët dhe serbët, etj.

Mirëpo, në anën tjetër, sa kemi punuar për t'i bindur qytetarët, se këta matrapazë të njëqind flamujve, janë të parët që e përbuzin flamurin kombëtar dhe atë e marrin si një leckë, ndërsa, flamujtë e të tjerëve, janë flamuj shtetërorë, të shteteve dhe kombeve të respektuara! Kushdo që del në mbrojtje të së vërtetës dhe i vë bllokadë mendimeve misionare, tash, të Brukselit, do të trajtohen, se nën këtë nënqiell po kërkohet luftë. Luftën e bëmë, por, atë e bëmë me armë, ndërsa, shtypin e verdhë dhe kolonën e pestë nuk arritëm t'i luftojmë dhe mu për këtë, kemi njohje formale të kontributit kombëtar, që nga Avdullah Kraishnica, Shaban Palluzha e deri të luftëtarët e UÇK-së.

Kjo na detyron të punojmë e mësojmë edhe më tepër, ta respektojmë shkollën e Tiranës, se dikur, si kundërpeshë, na i vënin shkollat e Beogradit dhe të Athinës, e, sot, na e vënë atë të Brukselit. Këtë njohuri, me dëshmi të fuqishme, duhet ta shpërndajmë te populli dhe t'i tregojmë secilit, kush janë këta si kategori, se emrat e përveçëm vështirë t'i shkëpusim, për kë punojnë, nga kush paguhen, pse e shtrembërojnë të vërtetën dhe pse i arsyeton elita politike.

Pyetje: – Shpërthimet e "reja patriotike dhe kombëtare", antiTiranë dhe antiShqipëri, këto të

ricikluarat e "reja" të "patriotëve" e të "shqiptarëve" në pushtetin e mediave, u panë edhe në debatin me kryeministrin Edi Rama, gjatë vizitës së tij në Prizren dhe në Prishtinë, me të ftuarit e zgjedhur gjithmonë në emisionet "debatuese" të Baton Haxhiut, tek Klan-Kosova, si i komentoni?

Përgjigje: – Ishte debakël i elites "analitike" të shtypit të verdhë!

Kjo nuk është e re në gazetari e publicistikë. Përsëri po na dalin dy shkollat, por, ajo e Beogradit na del më e fortë, në këto njëzetegjashtë vjetët e fundit, sepse, edhe Sali Berisha erdhi nga kjo shkollë. Duke mos e llogaritur të kaluarën, atë të paraluftës së Dytë Botërore, shkolla e Beogradit ka dhënë kuadro të forta në politikë, diplomaci, gazetari dhe krijon mision në bashkëveprim me kishën ortodokëse serbe, të mantalitetit të mesjetës, për shpërndarjen e kësaj fryme, duke e shtrirë rrjetin me devotshmëri, pa llogaritur mjetet financiare. Paratë e harxhuara e dhanë frytin e vet, nga gjenerata në gjeneratë, duke filluar me Fadil Hoxhën, Mahmut Bakallin, Azem Vllasin, Halil Matoshin e Nexhmedin Spahiun, në njerën anë, e në anën tjetër me Koçi Xoxën, Panajot Plakun, Xhavit Mustafën, Sali Berishën dhe mentorët e misioneve të huaja. Këtij sorollopi, sa herë t'i vjen ndoresh, do ta ngritë kokën, pa hezituar, madje, nganjëherë, edhe duke e humbur toruan se po zbulohen, siç doli në rastin e Edi Ramës, në Klan-Kosova. Ata, ethshëm e kanë pritur këtë përballje, për ta përmbushur misionin serb, se, ai, midis Beogradit, i dha shuplakë diplomacisë serbe, por, "kosovaristët", nga fukarallëku në tru, dolën humbës.

Nuk ka se si spjegohet ndryshe, se Serbia thotë, Shqipëria nuk ka nevojë të përzihet në punët e brendëshme të saj (do të thotë në Kosovës, sepse, me Kushtetutë e ka kësisoj); Serbia thotë, se ne do të dialogojmë në Bruksel për Trepçën dhe kjo

nuk lejohet të diskutohet jashtë Brukselit; Serbia thotë, ne i kemi fituar të gjitha luftërat dhe nuk do të humbim as në luftën diplomatike, ndërsa, Edi u tha, Serbia e ka humbur përfundimisht luftën dhe, atë, tri herë, që nënkupton, se ju ende ëndërroni për te, por, kot e keni. Madje, ata shkuan aq larg, sa u munduan ta akuzonin edhe për politikën në Shqipërinë londineze, se, kështu, siç u pa te Klan-Kosova, është mbjellë mentaliteti nga shkolla e Beogradit. Në fund doli si doli dhe duhet kuptuar njëherë e mire, se Enver Hoxhaj dhe "analistët oborrtarë" duhet t'i tumirin të gjitha mendimet dhe veprimet mbështetëse të Tiranës. Edi Rama e tha këtë me lakoni brilante dhe besoj se të gjithë e kanë kuptuar, pos disa kodoshëve që ishin në përballje me te, të cilët, nuk dinë t'i zbërthejnë mendimet e njerëzve të kalibrit të Kryministrit shqiptar.

Pyetje: – Kur e dimë, dhe e di edhe Tirana, që edhe sot janë në pushtet ata që u kanë përpiluar e përgatitur dosje shqiptarëve, në Kosovë e "Metohi", në Serbi dhe në ish-Jugosllavi, në mbrojtje të Serbisë e Jugosllavisë, a po ndodhë e njëjta dukuri edhe në "mbrojtje" dhe nën "protektorat" ndërkombëtar? Pse janë trimëruar kaq shumë bashkëpunëtorët e Jugosllavisë e të Serbisë, pushtuese e fashiste?

Përgjigje: – Me vendosjen e UNMIK-ut, në Kosovë, dhe krijimit të sistemit gjyqësor, janë tre veta që i emëruan gjyqtarët dhe prokurorët: Nekibe Kelmendi, Tadej Rodiqi (ky ka dënuar për politikë rreth 700 të burgosur) dhe Riza Smaka. Që të tre, duke menduar se u ka ardhur dita për ta sjellë drejtësinë në Kosovë, me kutin e bashkëveprimit të dikurshëm me pushtetin serb, përzgjodhën kuadrot, të cilat do t'i përmbushnin apetitet e Beogradit, që do t'i funksionalizojë UNMIK-u. Kjo garniturë e ndante, e ndanë drejtësinë në Kosovë dhe gjenerata e re, në këto dy fusha, nuk ka arritur të

depërtojë, pos atyre që kanë dosje gjatë punës së vet, ose që ishin servilë të pushtuesit, ose të pushtetarëve të sotëm, duke mos e përjashtuar edhe akraballëkun. Edhe sot, kjo kategori vranë e kthjellë! Shembull po e marr vetëm Kryeprokurorin, Aleksandër Lumezin. Kush ishte ai dhe babai i tij gjatë viteve të nëntëdhjeta?

Për të qenë të lirë në veprime të mëtejme, duke përdhosur gjakun e dëshmorëve të kombit, edhe garnitura e re politike i pranoi, madje, edhe i forcoi me kuadro shtesë, (vetë)kuptohet, me ata që kishin dosje, për të vepruar shlirë në krim të organizuar dhe për ta mbajtur pushtetin. Këtu qëndron forca e tyre dhe qëndrueshmëria në skenë, edhe të gjyqësorit, të pushtetarit, të gazetarit, të kuvendarit, sa, tash, janë lidhur personalitetet e dy kohëve, si vëllezërit siamezë.

Edhe më herët e kam thënë, se, sot, nuk kemi ndryshime në mentalitete të qeverisjes nga e kaluara dhe kjo ka bërë që në shënjestër të gjenden veprimtarët e çështjes kombëtare. Po t'i shikoni kuvendarët, kemi të tillë që janë në kuvend që nga 1992, por, me një ndryshim të vogël, ndryshimi i teserave të partisë, deri në legjislaturën e kaluar, ndërsa, sot, kemi një grup deputetesh diletantë, që nuk dinë as kur duhet dhënë mendimin dhe pse duhet dhënë. Duke qenë një përbërje e tillë kuvendarësh, që nga paslufta, lehtë mund të përfundojmë, se këta janë të etshëm t'i luftojnë partitë me orientim kombëtar dhe personalitetet që, në asnjë moment, nuk i bëjnë iso politikës ditore e partiake, antishqiptare.

Kjo politikë, e cila e ka vënë interesin e vet para asaj të përgjithshmes (kombëtarës), duke e rehabilituar gjithë sorollopin antikombëtar, ka bërë që kuadrot e elitës së vjetër titiste dhe asaj të re, rugoviste, dhe, të kësaj më të resë, brukseliane, të kenë fuqi dhe të mos përkulen para të vërtetave kombëtare, sepse, e kanë krah shtypin e verdhë, i

kanë dosjet e përgatitura dhe e kanë forcën e nxjerrjes së vendimeve.

Pyetje: – Edhe në të ashtuquajturin Kuvend i "Republikës së Kosovës", u debatua ashpër e me zë për dënimin e "Grupit të Drenicës", për denigrimin dhe shantazhin zyrtar të atij "Kuvendi" që po i bën, në vazhdimësi, luftës së lavdishme të UÇK-së dhe bartësve të saj. Madje, u shkua aq larg, sa u drejtohej gishti njerëzve të asaj lufte, më zi e më për t'keq sesa ia drejtoi Dick Marty. Si mund të komentohen dhe të emërtohen mëse drejti sjelljet e tilla të "kuvendarëve tanë"?

Përgjigje: – Inicuesi i këtij debati të kuvendarëve e ka ditur se kjo është një farsë, sepse, kjo u thirr pas aktit të kryer. Këtë e ka thirrur për të hapur fushatë elektorale për zgjedhje të parakohshme, mirëpo, kjo iu kthye si bumerang dhe, përsëri, dolën më të palagur rugovistët, sepse, ata nuk u munduan të jepnin deklarata, për të hapur debat kundërshtues, lavdëruese, përçmuese, por, sa për ta ndezur fitilin ishin aty dhe këtë e bënë me mjeshtri e finokëri të madhe.

Pse ishte pas aktit të kryer thirrja për debat dhe nxjerrja e një rezolute?

Qëndronin dy arsye thelbësore. E para, sepse gjykata e kishte dhënë vendimin e prerë dhe mbledhësit e nënshkrimeve u munduan të bëheshin sikur nuk kishin dorë në këtë vendim. Pra, ta shfajësonin veten. E dyta, kur shtrohet pyetja se kush e kishte formuar këtë trup gjykues? Na del EULEX-si. Pra, ky mekanizëm e kishte marrë pëlqimin e shumicën absolute të kuvendarëve, edhe për zgjatjen e mandatit të tretë. Prandaj, edhe nuk kishte kuorum për të nxjerrë rezolutë për rastin, sepse, në sallë nuk kishte më shumë se 70 kuvendarë.

Vetë mënyra e thirrjes ishte një farsë dhe domosdo se debati do ta merrte kahun e stërkeqjes, sepse, thirrësve u mungonte argumenti qenësor, kundërshtimi i veprimeve të EULEX-it. Këta, nuk kishin mandat ta zhvleftësonin vendimin e gjykatës, atëherë, përse u nxenë gjakrat?! Kujt u munduan t'i spjegonin dhe t'i lënë fajësinë për dënimet e dhëna?!

Duhet dalluar folësit: Rexhep Selimin, Fatmir Limën, Glauk Konjufcën, Albin Kurtin dhe Daut Haredinajn (fillimi i debatit), sepse, ata spjeguan, se nuk duhet bërë lojë me luftën shlirimtare, me luftëtarët e lirisë, sidomos, me komandntët, deri te ai i UÇK-së. Këto fjalime ka qenë dashtë t'i marrë për bazë Kryekuvendari dhe duhet ta mbyllte debatin, se, nuk jemi në situatë të qahemi e të lavdërohemi.

E gjithë kjo u shfrytëzua për elektorat! Kjo i gjasonte një parafushate elektorale! Dhe, në fushatat elektorale, nuk kursehen fjalët, nuk kursehen gjestet, nuk kursehen moshat. Në kësi lloj rastesh dallohen edhe të pameritуarit, që kanë zënë ulësen e kuvendarit, madje, edhe ata që duhet linçuar e larguar. Sidoqoftë, tagrën e paguajnë bashkëpartiakët, sepse, qytetarët i kanë përcjellë me vëmendje, pak me anime partiake dhe kjo le të jetë si shembull për të ardhmen, se, nuk e meritojnë të gjithë ata që kanë para, ulësen e kuvendarit.

Pyetje: – Ç'është e gjithë kjo përçarje dhe e gjithë kjo armiqësi mes partive tona politike? Kush ka gisht, kush po ua jap shtagën "shqiptarëve" në pushtet, që të sillen kështu, keq, kundër popullit të vet dhe kundër interesave të tij vitale e të Atdheut shqiptar?

Përgjigje: – Tramaku i zgjatur nga dora e dikujt, mëzatit i duket se është më i madh se atë që e ka në grazhdin e vet! Menjëherë, fillon ta lakmojë, sepse, nuk e di vlerën. Edhe te ne, me politikë po merren ata të cilët e kanë zgjedhur tramakun e kojshisë, se, kanë frikë mos grazhdi i tyre po zbrazet. Këtë tramak e kanë duart e pushtuesve dhe lakmia

për të qenë pushtetar i ka shtyrë të harrojnë, se, ku duhet t'i shkelin këmbët, pra, të qëndrojnë si Anteu. Po t'ua thuash këtë, menjëherë, do të të marrin për të çmendur, e, besa, nuk të kursejnë të të shpallin as për të tillë.

Ata që kanë interesa tek ne, kanë dy kuti për përzgjedhjen e liderëve. E para, sllavët kërkojnë të kenë njerëz me biografi dhe varësisht prej biografive edhe i ofrojnë mundësitë e prijësit. Edhe UNMIK-u, kur ka ardhur, mua më ka rënë në dorë një dosje "top sekret", e kam fotokopjuar dhe aty kanë qenë biografitë e secilit zyrtar, për të pasur kujdes në avansim dhe ndërprerje të marrdhënies së punës. Dosjet kanë qenë të përgatitura nga Beogradi, duke u nisur nga e imja dhe atyre që i njihja. E bëra publike dhe ata grumbulluan "disa fakte", por, tash, përmes Ahmet Isufit (Ministër), më suspenduan nga puna për tre muaj.

Amerikanët parapëlqejnë të gjejnë njerëz pa biogarfi dhe vetë t'ua rregullojnë atë. I dimë cilët janë dhe si ua kanë rregulluar biografitë.

Këto dy metoda, që janë përfillur e zbatuar në trojet shqiptare, kanë dhënë rezultate për të huajt, që kanë pasur mision për trojet tona. Dhe, po ta analizojmë mirë e mirë, kjo na del në pah në të gjitha fushat e jetës dhe në të gjitha qeveritë që janë krijuar në trojet tona, pas 1990. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në trojet tona, që janë nën pushtim klasik, përmes subjekteve politike që participojnë në krijimin e qeverive apo koalicioneve.

Kjo po na ndodhë në vitet e "demokracisë" që po e shohim në çdo hap, si rezultat i të tjerëve dhe, ne, ende nuk kemi arritur që të vetëdijesohemi dhe ta kemi një model autokton për përzgjedhjen e njerëzve në organet udhëheqëse e vendimmarrëse. Këtë, nuk e lejojnë këto dy rryma shumë të fuqishme kameleonësh, sa kanë arritur edhe t'i ndajnë "analistët e pavarur" në këto taborre. Disa janë të tejdukshëm,

se, për cilin mision punojnë, disa, nën petkun e të kaluarës, mundohen ta fshehin fytyrën e tyre të vërtetë.

Asnjë shqiptar i ndërgjegjshëm, nuk ka mundur ta marrë me mend se pas gjithë kësaj lufte, pas gjithë këtij gjaku të derdhur, trojet tona do të jenë në aeropag. Kjo lojë, po ndodhë që nga Kongresi i Berlinit, pa fije turpi, nga "miqtë" tanë dhe nga pushtetarët "tanë", duke amnistuar politikën maltusiane të serbosllavëve. Tanët e luajnë lojën e kalasë, kush do ta zë atë, se aty është grazhdi më i fortë, më i begatëm. Mu për këtë, kam bërë thirrje për mosdalje në zgjedhje, derisa, ne, t'i largojmë këto dy rryma nga jeta politike e vendimmarrëse dhe ta kemi një demokraci tonën, e cila di ta peshojë edhe kohën, edhe vlerën kombëtare, individuale e kolektive, pasuritë dhe forcën e kombit dhe ta koordinojë politikën për gjeneratat, sepse, këta po na i lënë trashëgim armiqësitë dhe luftën. Këtë, e kam thënë publikisht edhe në vitin 2005.

Pyetje: – Gjendja sociale është rënduar në tepri, kanë mbetur pa punë shumë shqiptarë dhe familjet e tyre janë buzë ekzistencës? Sidomos, bjen në sy mospërkujdesja për veteranët e UÇK-së dhe për familjet e tyre, madje, ka raste kur merren vendime politike për t'i larguar nga puna shqiptarët e pathyeshëm dhe, vetëm ata që ditën dhe dinë çfarë duan për ta bërë Shqipërinë. Vetëm ata që duan t'i largojnë përfundimisht nga politikëbëria dhe nga fushat e tjera shoqërore shqiptaro-titistët&Co. Çfarë mendoni ju se duhet bërë?

Përgjigje: – Në fillim, UNMK-u, Kosovën e ka shpallur pasuri të veten, ky fenomen nuk ka ndodhur askund në botë, duke pasur parasysh edhe shtetet e Afrikës, që e kanë përjetuar protektoratin ndërkombëtar. Një prej rregulloreve që e ka nxjerrë UNMIK-u, ka qenë ajo e privatizimit, e cila ngërthen në vete dy të këqija të mëdha, falë tumirjes së

lidershipit, në Kosovë. E para, nuk kanë pasur të drejtë konkurrimi ata të cilët nuk kanë veprimtari të njëjtë, do të thotë, shqiptarët janë përjashtuar nga privatizimi me Spinof special, e dyta, dhe më tragjikja, paratë e privatizimit, sikurse edhe ato të Trustit pansional, qarkullojnë jashtë territorit tonë dhe kamatën e tyre e shfrytëzojnë kompani të ndryeshme, që, nuk është çudi, që, nesër-pasnesër, të konkurrojnë me paratë tona për të bërë hulumtime dhe blerje e shfrytëzim të kapaciteteve tona nëntokësore. Ky privatizim, nuk është përcjellur ashtu siç e parasheh Regullorja, për tri vite dhe ta vlerësojë, në është drejtzbatuar, apo, jo. Praktika ka treguar, se askujt nuk i ka interesuar se çfarë do të ndodhë më tej, sa shumë kemi ndërmarrje që u është ndërruar destinimi, sepse, janë marrë para të majme nga institucionalistët, për fitimin e tenderëve, dhe, tash, nuk mund ta bëjnë kontrollin. Kjo ka bërë që edhe ajo pak industri që ka qenë, në Kosovë, të shkatërrohet nga misioni i "miqve" tanë, duke i shfytëzuar misionarët shqipfolësa. Kjo "mbikëqyerje" e pasurisë kombëtare, ka bërë që të shuhen shumë vende pune. Ky avaz vazhdon ende dhe askush nga pushtetarët nuk pranon që të rishikohet ky problem, madje, edhe ato subjekte politike, që dikur ishin në valle me të sotmit.

Ligji për Trustin pensional nuk ka qenë i detyruar, por, këtë e ka pranuar Qeveria, dhe, as që janë pyetur punëtorët, në duan për t'i derdhur mjetet e kursimeve në atë agjenci, dhe, është vepruar an bllok, për të gjithë.

Gjithë ky lloj "privatizimi" është bërë me (para)pëlqime politike, dhe, po t'i kishim kuadrot meritore në krye të institucioneve, kjo nuk do të ndodhte. Të gjithë kundërshtartët e kësaj loje, në forma të ndryshme, janë larguar nga marrëdhënia e punës ose i është ndërruar vendi i punës, jo nga ndërkombëtarët, por, nga argatët e tyre vendorë të sistemit të

shkuar, dhe të sotmit, të cilët, qe shtatëmbëdhjetë vite, e zhvatin qytetarin tonë.

Lidershipi, përmes kësaj loje, ka krijuar tre mekanizma mbrojtës, forcën ekonomike, përmes krimit të organizuar, ku bën pjesë edhe privatizmi i të dyja kategorive, kursimet pensionale, etj., pengjet e veta për marrje vote, duke ua lënë vendet e punës në kontratë mbi vepër, për dy e më shumë vite dhe mekanizmi më i fortë del, kontrolli i dy të parave, për të siguruar pushtet të mëtejshëm, në atë institucional e ekonomik.

Njerëzit e sinqertë dhe luftëtarët e njëmendtë, i kanë pasur këto mundësi, por, nuk kanë pranuar të hyjnë në lojëra të pista, për të krijar pasuri, duke mohuar mundin e vet, të familjes, duke mohuar gjakun që i është derdhur në zyrat e UDB-së dhe në vija të frontit. Kjo kategori, sot, është më e goditura, më e nëpërkëmbura, dhe, në anën tjetër, kurrë nuk ngritet zëri për uljen e pagave të kuvendit, për zvogëlimin e mëditjeve, për heqjen e mëditjeve në seancat kuvendore, për heqjen e benificioneve të kuvendarëve (shujtë, telefonata, vetura luksi, etj), ndërprerja e pagave për trurin e Kosovës, për heqjen e të drejtës për dy vende pune: borde, profesorë universitarë, ministra e zëvendësministra, etj. por, luhet me veteranët: se do t'u zbriten pensionet, ndërsa, për invalidët, edhe pas një viti të dhënies së mendimit të Komisionit Qeveritar, ende nuk është krijuar komisioni për përcaktimin e shkallës së invaliditetit, ku, edhe aty, bëhen lojëra të pista.

Pyetje: – A ekziston rreziku që veteranët e vërtetë të mbesin pa atë që e meritojnë, për t'i përmbushur pushteti kosovar e kosovarist orekset e atyre "veteranëve" që e shanë dhe e shantazhuan luftën dhe sot janë në listat e veteranëve?

Përgjigje: – Rreziku, veç është i dukshëm. Një pjesë, nuk ka konkurruar fare, kërkesa e një pjese as që është marrë

në shqyrtim, duke i ditur përcaktimet politike, ndërsa, një pjese tjetër i është mohuar kjo e drejtë, sepse, nuk ka pasur kë ta çojë mësit, përmes parave e ryshfeteve të tjera. Kjo lojë ka bërë që të hynë parashutistë, duke i marrë parasysh të tri metodat e theksuara më lart. Është paraqitur edhe fenomeni i mospranimit të çertifikatave apo mohimi, nga disa, për shkak të lojës që u është bërë shokëve të tyre. Të gjithë fajin e kanë ushtarakët që kanë pasur mundësi të japin deklarata, në mënyrë që të pastrohen stoqet e bërllokut që e ka mësyrë të pamerituarën.

Pyetje: – Kanë mbetur shumë keq shqiptarët e asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar, që erdhën vullnetarë në radhët e UÇK-së, e, edhe të tjerët. A nuk meritojnë edhe ata përkujdesje të veçantë shoqërore? A, më mirë do ishte t'i nderonim të gjithë luftëtarët dhe veteranët e asaj lufte apo që po nderohen e respektohen në kulm shqiptaro-titistët, të cilët e kanë uzurpuar pushtetin dhe e kanë kthyer në pronë familjare e private?

Përgjigje: – Jo vetëm shqiptarëve, por, kushdo që ka ardhur në luftën tonë shlirimtare, duhet t'u njihet e respektohet kjo e drejtë. Luftërat shlirimtare, pakës vërehen. Kjo luftë kishte karakter kombëtar, dhe, vetëm atëherë kur e kuptoi faktori ndërkombëtar, mori masa parandaluese, për të mos humbur Serbia. Kjo luftë, për shkak të karakterit dhe qëllimit që pati, bëri që të vijnë shumë vullnetarë nga kombe e shtete të tjera, edhe përtej Atlantikut. Në historinë e luftërave shlirimtare, ky fenomen është i rrallë, mu për këtë, të drejtën e veteranit duhet ta gëzojnë të gjithë, madje, qeveritë, në Kosovë, ka qenë dashtë t'i mbrojnë të gjithë ata për të cilët Serbia ka lëshuar fletarreste. Mbrojtja duhet nënkuptuar, punësimin apo pensionin, për të mos i lënë nëpër rrugët e botës, pa kulm mbi kokë, nga frika e kthimit në shtëpitë e tyre.

Pyetje: – Me ne po ndodhë sikuse në të kaluarën. Po copëtohen trojet tona edhe më keq e më për t'zi se në kohën e Kongresit të Belinit e të Konfrencës së Ambasadorëve, në Londër. Greqisë i falet det, thuase ka pak tokë shqiptare të pushtuar, Çamëri e deri në Peloponez... Bullgarisë pushtuese, të quajtur Maqedoni, i falet tokë shqiptare pos Maqedonisë që e mban të pushtuar, Malit të Zi, po ashtu. Po, çfarë do t'i falet Serbisë pushtuese, pas të të ashtuquajturit "Demarkacion" me Malin e Zi?

Përgjigje: – Në përgjegjen e mëparme, e theksova se kjo luftë filloi të marrë karakter kombëtar dhe këtë e ndërpreu faktori ndërkombëtar, me një pjesë bukur të mirë të faktorit tonë "prijatar", me nismën e tij. Kur shqiptarët e krijuan politikën e informimit të drejtë të luftës, të cilën deri atëherë e orientonte rugovizmi, përmes shtypit të verdhë, nga janari i vitit 1999, kombi filloi ta kuptojë drejtë këtë luftë dhe lojën e palës tjetër. Kushtrimi për shlirim dhe bashkim kombëtar filloi ta zgjonte ndërgjegjen e masës së gjerë, në vend e mërgatë, e, edhe të atyre ushtarakëve, të cilët sorollateshin në Malësinë e Tropojës e në Laprakë. Disa prej tyre edhe iu bashkangjitën shlirimtarëve.

Po të mos ishte propaganda e verdhë nga rugovizmi dhe krahu i tij berishist në Tiranë, që ia mbante ison propagandës së Beogradit, në këtë luftë do të përfshiheshin të gjithë shqiptarët dhe do të ishte përmbushur Betimi i UÇK-së. Nuk do të kishim pasur më probleme me Maqedoninë e Malin e Zi dhe çështja e Luginës as që do të diskutohej sot. Për mëtej, si problem, do të na kishte mbetur vetëm çështja Çame.

Misioni i sllavëve dhe pansllavistëve ka qenë në veprim të koordinuar edhe më herët se në Kongresin e Berlinit, mirëpo, atëherë, veç vihen konturat, nga pansllavistët, për gllabërimin e tokave tona. Zbatimi i Rezulutës së Kongresit të Berlinit nuk

ia ka arritur të zbatohej lehtë, por, një pjesë e saj do të zbatohej pas shpalljes së pavarësisë së Shqiprisë (1912), edhe pse Shqipëria ishte e pushtuar nga Tuqia, dhe, Evropa, si "Kurvë e Motit", për nevoja të veta, bëri shumë kompromise me sllavët, duke ua dhuruar fqinjëve tanë, trojet tona. Pra, Kongresi i Belinit e zyrtarizoi aeropagun. Ky mision është përcjellur në Posdam dhe në shumë konferenca e kongrese, deri te Konferenca e Paqes, në Paris (1945-1947).

Realizimi i këtij misioni, ku, mëse shumti përfituan nga loja e aeropagut sllavët, me krijimin e dy shtetetve: Serbisë e Malin të Zi dhe Maqedonisë, si republikë artificiale, në vitin 1945, për t'ia dhënë një pjesë të territoreve tjera shqiptare, gjë që, u arrit falë ndihmës së misionarëve shqiptarë, pazare që kishin filluar herët. Nuk dua të hyj në thellësinë historike, por, po nisem nga Esat Pashë Toptani, Ahmet Zogu, Koqi Xoxe, Panajot Plaku, të shumë bajraktarëve, dërzhavni imamëve (imamëve shtetërorë, që paguheshin ta kryenin misionin e sllavëve), posllanikëve (kuvendarëve), prefektëve dhe naçallnikëve (shefave e nënshefave) shqiptarë, e, më vonë, prej titistëve që mundoheshin, me çdo kusht, t'i nënshtronin shqiptarët, me ligje, me elaborate dhe me masa të tjera represioni politik, ekonomik, financiar etj., shumë ndëshkuese. Sa për ilustrim, po e përmendi Arsim Bajramin, sot ministër, i cili më 1989 ka dalë me dy elaborate: Se Kosovës nuk i takon Republika, të elaboruar me gjashtë pika dhe i dyti, se si duhet thyer qendresën e shqiptarëve përmes diferencimeve në famijle, fshat, shkollë dhe punësim. Pse e mora si shembull Arsim Bajramin? Sepse, ky ishte ekspert në Vjenë, proces të cilin e udhëhiqte Ahtisari, që karrierën e ka filluar si mbojtës i vlerave të ortodoksizmit, dhe, ky, ishte edhe bartës i projekt-kushtetutës dhe elaborues në Kuvend, që, me mjeshtri, e ka futë në këtë akt më të lartë, 80% të platformës serbe të prillit 2004. Pra, në këtë akt më të lartë juridik të Kosovës,

përcaktohen konturat e pavarësisë së shtetit, bisedimet me Serbinë për Kosovën, mospasja e të drejtës të krijojë ushtri dhe mundësitë e ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar në krijim qeverie, në përzgjedhje presidenti, në qokëzimin e vijave kufitare, në politikat e investimeve, në privatizim, etj.

Edhe sot, dëgjojmë rrahagjokse, duke pështpëritur se komisioni qeveritar nuk ka gabuar, se nuk gaboi me Maqedoninë?! Mundohen ta fshehin marrëveshjen e Serbisë me Maqedoninë, të vitit 2001, dhe elita politike shqiptare, që ishte në Kuvend, e miratoi dhe Kosovës iu morën 2100 hektarë. Nuk është aeropag ky? Sot, hamendën shqiptarët për kufirin me Malin e Zi! Po, a ka kob më të madh, që, me ndihmën e propagandës së verdhë, me veprimin e kolonës së pestë (ku bëjnë pjesë edhe ndërkombëtarët, të prirë prej vendorëve titistë), të jenë në shërbim të misionit malazez, synim që Mali i Zi e kishte që nga Kongersi i Berlinit.

Poqëse i shikojmë rrjedhat e derisotme të garniturave qeverisëse, atëherë, duhet mobilizuar urgjentisht, sepse, kufiri mund të na vjen deri në Ibër. Për të mos ardhur deri këtu, duhet ndërprerë projektin e Zajednicës, projekt i faktorit ndërkombëtar, për të mos e lënë Serbinë t'i shkojë në krah Rusisë. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me Pakon e Ahtisarit, por, kemi të bëjmë me modelin e Kongresit të Berlinit, atëherë, kur Turqia dhe Evropa (tokat shqiptare i shkonin te sllavët, se po hidhërohet Rusia!), ndërsa, sot, Serbia dhe Evropa (tokat shqiptare duhet të shkojnë te sllavët se po hidhërohet Rusia, sepse, Serbia ka nënshkruar kufijtë e jashtëm të Kosovës, pa praninë shqiptare). Ata të cilët nuk e zbërthejnë këtë enigmë sot (kuvendarë e intelektualë, se ASHAK-u me kohë është betuar se nuk do të dalë nga misioni i sllavëve), ose, nuk janë në rrjedha politike e historike të kombit tonë, ose, janë misionarë të misionit sllavomadh.

Pyetje: – Si ka mundësi logjike që të ndodhin gjëra të tilla para hundëve të njerëzve përgjegjës, në radhë të parë, të atyre njerëzve që ishin në krye të luftës sonë dhe kush na i qiti në krye, kur, bartës të luftës politike, diplomatike dhe luftarake ishin shqiptarët dhe jo shqiptaro-titistët, që u involvuan dhe u rehabilituan plotësisht?

Përgjigje: – Shoku Tafil, mos të harrojmë se lufta ishte përgatitur nga gjenerata të tëra, në vijimësi. Shumë breza kishin kontribuar për heqjen e frikës te bashkëkombasit e vet dhe kur arritën që gogolin Serbi t'ia heqin nga koka, lindi edhe momenti për t'i rrokur armët.

Hegeli thotë: "Njerëzit e lindin kohën dhe koha i lindë njerëzit". Sipas këtij parimi, secila gjeneratë ka lindur një kohë dhe nga ajo kohë kanë dalë njerëzit që e kanë shtyrë procesin mëtej. Këta nuk ishin njerëz dosido, por, njerëz të guximshëm të pendës dhe, sipas nevojës, edhe të gatshëm për t'i rrokur armët.

E para, kategoria që parapërgatiti lindjen e kohës së UÇK-së, shumë pak ose aspak u mor në konsideratë, gjatë dhe pas lufte, dhe, atë, duke zgjedhur me pincetë, më të dëgjuarit. Kjo edhe e shpjegon logjikën e krijimit të vakumit me kuadro. Ky vakum duhej plotësuar dhe është plotësuar me njerëz, protagonistë të vënies së frerit çështjes kombëtare, si misionarë, sepse, detyrën e kishin marrë nga misioni. Ky bashkëdyzim kimik, domosdo, krijon lëgurë, (lëng, gas, etj.), pra, ari dhe argjendi nuk mund të krijohen me përzierje. Derisa UÇK-ja ishte ar, këta e rrokullisën në humnerë, me ndihmën e ndërkombëtarëve, të cilëve u paraprinë pacifistët "shqiptarë". Si dëshmi, mund t'i marrim proceset gjyqësore që ndodhën dje, po ndodhin sot, dhe, që do të ndodhin edhe nesër, ku, pothuaj, të gjithë ata të cilët dikur e shanin UÇK-në për prishje të miqësisë me Serbinë, janë të kënaqur dhe mëzi

presin ta marrin dënimin e "merituar" shlirimtarët, atë dënim që nuk kishin munduar t'ua shqiptonin, dikur, publikisht.

Mënjanimi i veteranëve të rezistencës kombëtare dhe afrimi i mercenarëve, i kolonës së pestë, i shtypit të verdhë, si zëvendësim, e ka prurë gjendjen në këtë shkallë dëshpëruese, mirëpo, përgjegjja është me adresë dhe nuk kemi pse hutohemi. Përsëri, do të jetë kjo kategori që e lindi epokën e UÇK-së, ajo që do t'i mbrojë vlerat e saj, duke ua ngrirë buzëqeshjen në buzë titistëve dhe rugovistëve, të cilët edhe i fabrikuan dosjet për Gjykatën e Hagës, e, edhe për Specialen.

Pyetje: – Unin tënd luftarak e largpamës politik, pos publicistikës, e shtrini edhe në poezi, rrëfime, drama romane historike etj, por, ajo bërthamë uni kombëtar e atdhetar, kombkrijues e atdhebërës, sikur del më e theksuar te intervistat e imagjinuara, me personalitete të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe fytyra të njohura të historisë shqiptare. Çka mund të na thoni, duke e barasvlerësuar me kontekstin kohor? A jemi unik konform situatës, si faktor njerëzor e kombëtar?

Përgjigje: – Ke të drejtë, shoku Tafil. Duke i parë rrjedhat e politikës plangëprishëse, i jam kthyer kohës së krijimit të bërthamës kombëtare, që të arrij, pakashumë, ta zgjojë ndërgjegjen e intelektualëve, sidomos, të atyre në arsim dhe të studentëve, të cilët thirren në këtë ajkë të kombit, e, në anën tjetër, nuk i përfillin mesazhet e ajkës. Duke bashkëbiseduar me ta, kuptohet, përmes veprave të tyre, kam ngritur zërin për t'u trokitur edhe në ndërdijen e fjetur e amullore të pushtetarëve, të paktën, tek ata të cilët edhe kanë arritur ta mobilizojnë luftën për shlirim e bashkim kombëtar. Ky bashkëbisedim me ta, e ka edhe mesazhin tjetër, për ta zgjuar ndërgjegjen e një kategorie të ish të burgosurve politikë,

të cilët, për para e kulltuqe, kanë harruar kush janë e nga erdhën.

Përmes tyre, jam munduar t'i bëjë edhe krahasimet kohore të tyre me tonat, sepse, atëbotë, as që flitej për shqiptarët si etni, e, lëre më si komb. Kushtet në të cilat kanë vepruar ata dhe kushtet në të cilat kemi vepruar e veprojmë ne, as që mund të merren me mend, mirëpo, ata ishin bërësit e historisë dhe të krijimit të shkollës kombëtare. Mundësitë e komunikimit të tyre mesvete dhe mundësitë tona kanë dallime shumë, shumë të mëdha, sa nuk mund të imagjinohen. Ata komunikonin përmes lajmëtarëve, përmes shtypit të huaj, përmes gjuhëve të huaja, në e nga të gjitha vendet e botës. Ata bënë hapa të mëdhenj për çështjen kombëtare, duke e bërë atë si çështje që duhet zgjidhur në qarqet ndërkombëtare, të cilat edhe e ngatërruan. Ata arritën që Evropa ta pranojë çështjen kombëtare shqiptare, që do zgjidhje, dhe, deshi nuk deshi, Kongresi i Berlinit u detyrua ta pranojë. Thënë thjesht, përkundër shumë vështirësive, në çdo segment, ata arritën ta përafrojnë një platformë kombëtare, shtetformuese e kombkrijuese. Ata arritën ta bëjnë alfabetin shqip (1908) dhe atë politik (1878-1912). Ne, në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të kaluar, i mohuam, të parën dhe të tretën. Madje, edhe sot, kur po flasim. Ne, jo që nuk u morëm me platformë politike, por, nuk ditëm të krijojmë as alfabet politik kombëtar, të cilat mosveprime, edhe mëtutje, do ta dëmtojnë kombin, të cilat, edhe mëtutje, do t'i rreshtojnë bashkëkombasit në vija e taborre politike armiqësore, të cilat, përmes kësaj politike që bëhet në të gjithë atdheun, nuk do të lejojnë të ulen njerëzit e pendës, me dinjitet kombëtar, për ta bërë një platëformë kombëtare, mbështetur në atë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe në atë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sepse, ajo është kapërthyer nëpër programe e satatuse partiake e bajraktarllëke. Kësaj i thonë, zgjidh e merr, akëcilin subjekt

politik dhe kjo ka bërë që shumë intelektualë të dalin nga radhët e partive, por, e keqja është, që nuk ulen së bashku, për të bërë diçka në këtë drejtim.

Ne, sot, duhet, përmes veprave, përmes jetësimit të tyre, të krenohemi, por, edhe të turpërohemi që nuk kemi arritur, të paktën, aty ku ishin ata dhe nuk di se si, disa, kanë fytyrë ta gënjejnë në këto përmasa kombin, madje, ky sorollop, as që duhet të dalë para kombit, t'i flasë atij. Ata e patën mendjen, guximin dhe i shkrinë të gjitha pasuritë që patën, për çështjen kombëtare, ndërsa, ne, ende pa u tharë gjaku i dëshmorëve, filluam t'i mbushim xhepat me para dhe këtë e spjegon mëse miri Ali Asllani, te "Hakërrima".

Po ta analizosh punën e tyre, veprën e tyre, ne duhet t'i themi tokës: Hapu e na përpij. Ne, ende i duartokasim tradhtisë. Çfarë bëri më shumë Abdullah Pashë Dreni, sesa "elita politike", nga viti 1990, në gjithë hapësirën kombëtare?! Me heqjen e tij, hoqën kancerin nga trupi i shëndoshë i Lëvizjes. Çfarë bëri Esati më shumë se Sali Berisha, e këta të sotmit me "Zajednicën" e kufijtë me Maqedoninë e me Malin e Zi?! Ata, e dënuan aktin dhe mbeti pa u nënshkruar ndarja dhe copëtimi i tokave shqiptare. I pandëshkuar mbeti Zogu, por, zogollët po veprojnë dhe i ngritën permendore në Tiranë. A mund ta mbajë, ky truall, këtë turp, që i dhanë qeveritarët e Shqipërisë londineze dhe liderucët e subjekteve politike nga trevat e tjera kombëtare? Ndërsa, pinjollit të tij, qytetar Durrësi, i krijohen favore, sa vetëm që nuk kanë guxim t'ia vënë kurorën mbretërore. Erjon Velijaj u shndërrua në ofiçar, para një hiçi, dhe, po ta pyesësh atë (Erjonin), kishte kurorëzime në Tiranë gjatë mandatit të tij, që e meritonte t'i bëhej ofiçar, madje, edhe ta kishte për nder për tërë jetën? Ky stërnip Kaini mbështetet edhe nga dallkaukët, pa e ditur se çfarë po bëjnë, për nder apo për inat të kujt!

Të intervistuarit, e kanë pasur të qartë se për çfarë kauze luftonin. E kanë pasur dhe e ka të qartë "elita politike", për çfarë vepruan dje dhe sot? Në këtë plan, sondazhet do të na e pasqyronin minusin!!!

Pyetje: – Si ndodhi që të këqijat na erdhën vargevi, njëra pas tjetrës, sidomos, pas luftës së lavdishme të UÇK-së, ku, patriotët, kontribuan madhorisht dhe ndihmë të pakursyer keni dhënë edhe ju, personalisht, e, edhe familja e Juaj?

Përgjigje: – Në këtë pyetje jam përgjegjur, pjesërisht, më lart. Ne të dy, shoku Tafil, i takojmë gjeneratës që ka lindur dy e tri kohë dhe kemi ecur bashkë me njerëzit që i ka lindur koha. Kur e kemi parë se nuk kanë vazhduar në mënyrë të merituar, duke mohuar njerëzit që e kanë lindur kohën, thënë shqip, njerëzit që e kanë bërë historinë, jemi ndarë me ta dhe kemi ecur përpara, duke mos u mashtruar pas lakmive që na i ka mundësuar ajo kohë, se, në plan të pare, kemi pasur dhe e kemi çështjen kombëtare. Najadat nuk kanë arritur të na ndalin, por, as kërcënimet e armikut bashkë me emisarët e tyre. Ne kemi arritur të ecim nëpër tehun e shpatës dhe besoj se jemi promoterë të çështjes kombëtare. Këtë vlerë nuk kanë ditur ta çmojnë edhe protagonistët e dalë nga UÇK-ja, mirëpo, i diktuam menjëherë dhe jemi munduar ta emancipojmë popullin, duke i treguar edhe grackat e ndërskamcat që po i vendosin ndërkombëtarët bashkë me gjakpërzierit. U kemi treguar për misionin që kanë sllavoortodoksët dhe kush po u ndihmon, qoftë nga ndërkombëtarët, qoftë nga vendorët.

Duhet urti, guxim dhe njohuri për të qëndruar përballë këtyre rrebesheve, sepse, ndryshe është kur je i organizuar në një subjekt politik, ndryshe kur u vihesh përballë të gjitha të këqijave që i ndodhin kombit, i vetmuar, por, ngadalë i krijon mbështetësit e tu dhe kjo ta shton edhe më tepër guximin për përballje edhe më të mëdha, e, me shumë rreziqe. Të tilla kam

pasur edhe pas lufte, por, ja ku jam, edhe më i fortë, edhe më i përgatitur për ballafaqim me këdo, e kurdo.

Pyetje: – A nuk ishte dhe nuk është në gjendje intelegjenca shqiptare që t'i (para)ndalojë a t'i ndërpresë ato e këto të këqija? Nëse po, pse po ndodhë e kundërta?

Përgjigje: – Intelegjenca!

Varet se si e merr intelegjencën e një kombi. Të thirrurit, pra, ASHAK, kanë humbur në humnerat e armikut, se ende nuk kanë arritur të dalin nga gëzhoja e vet, ndoshta kanë mëkate shumë më të mëdha sesa mund t'i dimë ne. Kjo është ajo zyrtarja, për të cilën edhe paguhen. Por, edhe në Shqipërinë londineze kemi një akademi të heshtur dhe nuk e tregon veten në kohët kur kërkon shpëtim atdheu, këto njëzetegjashtë vite. Që të dyja, janë jashtë misionit që e kanë.

Intelegjenca, edhe kjo është e ndarë dhe e përçarë. Një pjesë ka kaluar në subjekte politike, një pjesë, fatkeqësisht, në ato fetare. Ata dinë të shkojnë aq larg, të kushtëzuar nga politika ditore e feja, sikurse në Kuvendin e Kosovës, kur i drejtojnë gishtin njëri-tjetrit. Kjo është mëkatare sikurse e para, sepse, e mbështetë kursin qytetar, e, jo atë kombëtar.

Një pjesë e intelegjencës e dinë se ka ardhur koha e tyre, por, për shkak se i duhen buxhete për promovimin e vetes, përmes librave, paraqitet indiferente për ngjarjet që po ndodhin me ne e rreth nesh. Ata janë të vetëdijshëm për misionin e armikut dhe të të huajve, por, janë një lloj narcisoidësh dhe frikësohen se pas vdekjes do t'u harrohet emri, por, pse jo, edhe për së gjalli të krekosen para qytetarëve, se "ka kush merret me çështje kombëtare".

Kategoria e fundit e intelegjencës, që çështjen kombëtare e ka vu mbi të gjitha çështjet e interesat, është e shkapërderdhur, pa mjete financiare, dhe vështirë e ka ta bëjë punën kolektive. Sado që vepron, në të gjitha planet, si

individualiste, vështirë e ka ta kryejë misionin e vet, por, pakashumë, ka arritur ta zgjojë ndërgjegjen kombëtare, dje e sot. Të tillët edhe përbuzen, nën moton, se ju nuk po bëni asgjë, por, realiteti thotë ndryshe. Nëse arrin t'i shkëpusi njëqind veta nga gjahu që i bëhet kombit, ai ka arritur ta përgatit një kohë tjetër, që do të lindë njerëz të rinj.

Besoj, se këta njihen mesvete dhe domosdo, një ditë, do të ulen për ta binarizuar veprimin kolektiv kombëtar. Koha nuk pret për këtë, sa më shpejt të gjendën mundësitë, aq më mirë për çështjen kombëtare.

Këtë moment jemi duke e pritur edhe ne të dy.

Pyetje: – Po ashtu, kontribut shumë madhor dhanë edhe ushtarakët dhe luftëtarët nga atdheu amë, Shqipëria londineze, të cilët erdhën t'ia falin jetën Atdheut të tyre shqiptar, pa kursyer as familjet e tyre. Pse e gjithë kjo mosmirënjohje për ta dhe për kontributin e tyre dhënë Kombit e Atdheut?

Përgjigje: – Po, i njoh disa dhe e di në çfarë pozite janë. Edhe më lart e kam thënë, se kur filloi i gjithë kombi të luftojë për ta kryer misionin e dëshmorëve të shumë gjeneratave, ndërhyhet në Serbi, për ta shpëtuar atë, në të kundërtën, sot, do të ishim shtet-komb. Kjo edhe do t'i ketë pasojat e veta, sepse, një veprim të tillë nuk ta falë armiku me mbështetësit e tij dhe natyrisht se do të marrë veprime konkrete për të gjithë. Së pari, u morën me ata të cilët nuk i takonin Kosovës administrative, atyre nga trojet shqiptare në ish Jugosllavi, duke iu kthyer pastaj atyre të Shqipërisë londineze. Kemi shumë luftëtarë lirie që janë nëpër shtete të perëndimit, madje, edhe përtej Atlantikut, të cilëve nuk iu dha ndihmë, qoftë në punësim apo strehim.

Rastin e Dilaver Goxhajt (Shpëtim Golemit) e kam bërë publik, kur, me ndërhyrjen e Ismail Kadaresë, Rugova e largon nga Kosova, veç sa ishte stabilizuar me gruan, në Prishtinë.

Ka edhe të tjerë, por jo edhe të aso përmasash, por, që nuk iu shtri dora për kyçje në jetën publike e institucionale, duke qenë të gjithë specialistë të fushave të ndryshme ushtarake. Këtë e kanë bërë nga gjelozia e njohjes së problemeve, në njërën anë, e, në anën tjetër, për t'i fshehur nga syri i popullit, edhe i tyre, koketimet me ndërkombëtarët, për fatin e ushtrisë. Kjo, veç doli në shesh, më në fund, nga Ministri i FSK-së.

Pyetje: – Cili prej ushtarakëve dhe luftëtarëve shqiptarë të UÇK-së ju ka lënë mbresa atdhetare e kombëtare, kur dihet, pa asnjë dyshim, se të gjithë (nuk) ishin të tillë? A mund ta veçojmë ndonjërin?

Përgjigje: – Ka disa që i kam njohur personalisht, që sot janë dëshmorë, të cilët, në supet e tyre, e kanë bartur misionin e shlirimit dhe të bashkimit dhe jam i bindur, se, ata, po të ishin gjallë, nuk do të ishim në këtë gjendje të mjerë. Ende kombi nuk ka arritur t'i vlerësojë siç e kanë merituar, se, njohja e statusit të dëshmorëve të Kosovës është përçmim, kur ata i kanë qëndruar besnik kauzës kombëtare, për të cilën kanë luftuar edhe më herët, siç janë: Adem dhe Hamëz Jashari, Fehmi Lladrofci e Xhevë Krasniqi-Lladrofci, Ismet Jashari, Tahir Sinani, Remzi Ademi, Shaban Shala, Zahir Pajaziti, Xheladin Kurtaj, Mensur Zymberi, etj.

Edhe nga të gjallët, i kam njohur disa, para lufte, por, e kisha veçuar Alush Shalën dhe Ramiz Qeriqin, e ndonjë tjetër, por, me sa kam dëgjuar e hulumtuar, Ramush Haradinaj ka qenë Komandant me plotkuptimin e fjalës, në vijë fronti, duke ecur në ballë të kolonës, edhe gjatë luftimeve. Të tillë kanë qenë, pa dyshim, edhe Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, etj.

Pyetje: – Na shkuan dhe po na shkojnë punët krejt tarapushk, kush po na tarapushkatë kësisoji dhe pse po lejohen këto tarapushkatje, në kurriz të kombit e të Atdheut. Një komb jemi, një Atdhe e kemi!?

Përgjigje: – Një atdhe?! Një pjesë bukur e madhe (ajo që ka qenë kundër luftës) ka filluar ta quajë atdhe Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Kjo paksa është e rëndë dhe, për ta, fyese. Ky është moment. I di kohët në të cilat këndohej flamuri kombëtar e betohej në po atë flamur. Ku jemi sot? Jemi shkapërderdhur si zogjtë e qyqes, nëpër foletë e huaja dhe na e vështirësojnë jetën, e, diku, edhe mbijetesën kombëtare. Njerëzit e etshëm për pushtet e para, luajnë me ndjenjat kombëtare, me flamurin e kombit, me hymnin e kombit dhe këta e tarapushkatin të djeshmen, të sotmen, e, nëse u lejohet ky komoditet, edhe ardhmërinë e të nesërmen tonë.

Mu për këtë, misionarët e çështjes kombëtare, duhet të punojnë në të gjitha frontet, për ta parandaluar këtë katrahurë dhe për t'i shpjeguar popullit se çfarë misionarësh janë dhe në cilin mulli e dërgojnë ujin. Edhe më herët e kam thënë, duhet të mësohemi me punë kolektive, ta binarizojmë çështjen në drejtimin e duhur, pastaj, me pak punë të mençur, ajo ecën vetvetiu.

Pyetje: – Si ndodhi që u shiten idealet tona kombëtare te shqiptaro-titistët dhe të kategoria e tyre e të "burgosurve politikë shqiptarë", e cila kategori është shkaku, shkaktari kryesor dhe pasoja që lufta shqiptare për Shqipëri të degjenerojë në këtë derexhe?

Përgjigje: – Demokracia në kushte robërie e dëmton çështjen kombëtare. Ky ka qenë mendimi im që në fillim dhe i kam qëndruar besnik kësaj motoje deri më sot. Armiku, përmes kësaj loje politike, e ka kontrolluar lëvizjen tonë dhe, këtë, mëse miri e shpjegon Veton Surroi, në një artikull për "Borbën", më 04. 7. 1990, ku e sygjeron Beogradin të mos e përjashtojë LDK-në nga loja, sepse, shqiptarët kanë ekspeseriencë të madhe në ilegalitet, prandaj, vështirë është të gjendet udhëheqja e saj, kur të gjithë janë në lëvizje.

Ky ishte hapi i parë dhe mjaft efikas, për zvogëlimin e bërthamës kombëtare, duke i përfshirë në rrethin e vet, me joshje të nduardurta, edhe një kategori të të "burgosurve politikë", që u bë një levë bukur e fortë për ta topitur ndjenjën e revolucionit kombëtar. Efektet e saj, tashmë, janë të njohura për të gjithë, por, e keqja, as Azem Vllasi nuk e kritikon titizmin, e millosheviçizmin, por, edhe këta nuk e kritikojnë rugovizmin dhe mundohen që për të dyja epokat (rugovizmin dhe UÇK-në) të nxjerrin merita, kohë të cilat e luftuan njëra-tjetrën. Duke qenë në këtë pozitë, mundësuan dhe e shtrinë rugovizmin në një kategori të ish-luftëtarëve të UÇK-së, dhe, tash, jemi më zi sesa atëherë. Këta ditën ta luajnë lojën bukur, dhe, edhe sot, nuk janë pa hise në legjislatura e beneficione.

Ata të cilët u qëndruan besnikë idealeve kombëtare, janë të paktë dhe për kombin e vet kanë vetëm të drejtën morale, edhe pse vështirë e kanë t'i përhapin idetë e tyre, t'i përcjellin mesazhet e tyre, se, në radhë të parë, do të sulmohesh nga bashkëvuajtësit dikur, nga bashkëluftëtarët dikur, ngase, armiku e përdorë mashën për ta kapur gacën. Këtë punë e bëjnë edhe rugovistët. Populli, edhe për një kohë të gjatë ka për t'i parë në arenë përplasjesh ata që dikur ishin nderi i kombit. Kur të arrijmë ta zbërthejmë këtë enigmë, besoj se, do ta kemi këndelljen kombëtare.

Pyetje: – Madje, idealet e të burgosurve politikë shqiptarë, u kompromituan keq, me marrjen e një "dëmshpërblimi" prej atyre shqiptaro-titistëve që ishin shkaktarët kryesorë dhe veglat kyçe të pushtetit për përndjekjen dhe burgosjen e shqiptarëve? Pse ndodhi kjo shëmti?

Përgjigje: – Kanë thënë, çka ta bën i yti nuk ta bën askush, sepse, vetëm ai di të të çmojë dhe përçmojë. Me "Dëmshpërblimin" jemi përçmuar dhe ky përçmim vjen nga Shoqata e të burgosurve politikë. Ne, asnjëri nuk kemi qenë

mercenarë, siç ka ndodhur gjatë luftës. Mercenarët (bashkëpunëtorët), janë diktuar menjëherë dhe vetë të burgosurit politikë i kanë larguar nga rrethi i vet. Por, këtë lloj shpërblimi, unë dhe disa shokë, e kemi kundërshtuar, sepse, asnjëri nuk e kemi ditur, në radhë të parë, do të mbesim gjallë apo jo, sepse, edhe aty bëhej luftë për jetë a vdekje. Kemi shumë shokë që janë vrarë gjatë torturave, cilën kohë do t'ia llogaritim për "shpërblim", atë kohë që përjetoi torturat dhe nuk ka arritur t'i bëjë mbi dy muaj, siç është rasti i Xhemaili Berishës (për 24 orë)! Shumë shokë kanë mbetur invalidë për gjithë jetën, nga torturat e bëra ndaj tyre, prandaj, shtrohet pyetje, mund të shpërblehet gjendja e tyre shëndetësore, që, brenda dy mujave ka dalë i paaftë për jetë e punë, kur, ata, nuk janë trajtuar fare, pas lufte?! Rastin e kemi me Metush Krasniqin, cilat shuma do t'ia dëmshpërblenin torturat e pësuara dhe vdekjen e tij prej tyre, pas daljes nga burgu, apo, kohën e regjistruar në vuajtje dënimi?!

Pastaj, shuma e "dëmshpërblimit" është shumë poshtëruese! Pothuaj, jemi trajtuar sikurse sot të pafajshmit, kur lirohen. Krahaso gjendjen e të burgosurve politikë në Burgun Qendror në Beograd, Goli Otok, Gospiq, Stara Gradishë e në shumë burgje të tjera dhe krahaso ato të sotmet. Me një fjalë, këto vuajtje nuk mund të mbulohen me asgjë, e, aq më tepër me mënjanimin e torturave gjatë fazës së hetuesisë.

Këtë "dëmshpërblim" nuk ka pasur nevojë ta bëjë Qeveria e Kosovës, por, kjo çështje ka mundur dhe është dashur të shkojë në Gjykatën Ndërkombëtare të Strazburgut, e, të zgjidhet sipas konventave e ligjeve ndërkombëtare. Siç duket, ndërkombëtarët me qeveritarët dhe Shoqatën janë marrë vesh dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar i ka garantuar paratë, kjo ka ndodhur për ta hequr nga përgjegjësia penale e juridike

Serbinë, për fashizmin që e kanë ushtruar në kurriz të të burgosurve politikë shqiptarë.

Në këtë lojë i kanë futur edhe robërit e luftës dhe këta i kanë ndihmuar shumë Serbisë, duke mos ia dhënë tretmanin e duhur kësaj kategorie, e cila do ta kishte nxjerrë dëmshpërblimin të merituar, siç e nxori Afrim Zeqiri.

Do të mirëpritej dëmshpërblimi, të cilin edhe e kam propozuar publikisht, kur të dalë NN në pension, të merr pagë sa gjysma e pagës së Presidentit, ose njëzetepesë euro për njëzetekatër orë qëndrimi në burg.

Në fund, jemi trajtuar si mercenarë, ne që dolëm parzmore para armikut, për ta mbrojtur dinjitetin kombëtar, për ta përgatitur terrenin për shlirim dhe bashkim kombëtar dhe në fund ta gëzonim të gjithë njësoj këtë liri, por, kjo u bë për të na e mbyllur gojën të flasim për epoka kombëtare. Edhe po deshëm, ne, të heshtim, nuk e lejon historia këtë, sepse, në fund të fundit, jemi bërësit e historisë, dikush në vazhdimësi e dikush është lodhur dhe është larguar nga rrugëtimi maratonik. Por, një gjë duhet ta kenë parasysh, të gjithë lojtarët e kësaj maskarade, penda dhe gjuha e misionarit për çështje kombëtare, nuk do të ndalen kurrë!

Pyetje: – Rrethanat, sa po vinë e po ngushtohen më shumë, në horizonte rajonale e botërore ka zhvillime të paparashikueshme politiko-ushtarake. A mund t'i rezistojmë, në rrethanat ekzistuese, ndonjë "befasie" ushtarake të fqinjëve dinakë përreth dhe të aleatëve të tyre?

Përgjigje: – Lufta! Kohëve të fundit, (për)flitet shumë për Luftën e Tretë Botërore. Kjo nuk ka për të ndodhur, për shkak të potencialit të madh bërthamor. Ta kujtojmë vetëm një rrjedhje të pakët, që ndodhi në Çërnobil. Krahasuar me ngarkesën që kishte ajo, e, të mos flasim për ngarkesën që kanë Fuqitë e Mëdha, me ç'rast pasojat ishin tepër të mëdha,

sa ndihen edhe sot. Kjo është më tepër manovrim i supërfuqive, për t'i frikësuar shtetet të cilat mundohen t'i mbajnë për koloni politike e ekonomike. Këtë, mëse miri e shpjegon Kisinxheri (parafrazim): "Sot, në botë ekzistojnë pesëmbëdhjetë kilogram eksploziv klasik për kokë të çdo banori, sa ka edhe për kokën e Niksonit, edhe për kokën e Brezhnjevit" (1978).

Te ne, është po e njëjta gjë. Bashkësisë ndërkombëtare i ka kushtuar shumë lufta dhe vështirë se mund ta aktivizojnë këtë bombë të kurdisur dhe mu këtu ka qenë dashtë të mbështeten politikëbërësit. Pra, gjeopolitika dhe gjeostrategjia na jep përparësi për realizimin e të drejtës tonë, shtet–komb. T'i marrim vetëm dy shembuj, atë të Palestinës dhe të Bosnjës. Në Palestinë, ende bëhen eksperimente të supërfuqive, derisa këtë ta kuptojnë të gjitha palët ndërluftuese, se, e gjithë kjo bëhet për ta treguar forcën amerikanët, rusët dhe paraja. Në Bosnje, kur u pa se situata doli nga kontrolli, sidomos, me masakrën e Srebrenicës, supërfuqitë e ndërprenë dhe u takuan në Dejton, jo për ta zgjidhur situatën, por, për ta krijuar një situatë të re, sepse, këmbëngulja Ruse për një Serbi të Madhe, mposhti interesin e palës tjetër. Ai territor nuk paraqiste interesa globale, mirëpo, u la si fitil detonatori, për çdo rast. Te ne, situata është krejtësisht ndryshe. Këtu, kur u pa se lufta do të merrte përmasa rajonale, ku do të përfshiheshin Maqedonia, Mali i Zi, Greqia, Bullgaria, Rumania, Turqia dhe Hungaria, nga të dyja taborret e supërfuqive, u ndërmorën masa të menjëhershme. Pra, Fuqitë e Mëdha e dinin se këtu nuk mund të përdorej loja e Palestinës dhe e Bosnjës, por, duke e falënderuar lidershipin e shqiptarëve në Rambuje, arritën vetëm ta lokalizonin bombën dhe jo ta çaktivizonin atë, duke i dhënë shumë të drejta, me Rezolutën 1244, dhe, sidomos, me Pakon e Ahtisarit, Serbisë.

Nëse shqiptarët këmbëngulin në të drejtën historike, nëse shqiptarët këmbëngulin në të drejtën e popullimit, nëse këmbëngulin në të drejtën e konventave ndërkombëtare për referendum, ne, jo vetëm se mund t'i shmangim kërcënimet deri në luftë, por, edhe mund ta realizojmë betimin e dëshmorëve të të gjitha kohëve. Ne, nuk e njohim vetveten, ne nuk e dimë sa banorë jemi, ne nuk e dimë se çfarë pasurie kemi, që, të tjerët, ëndrrojnë të flenë mbi këtë pasuri, të zgjohen në këtë pasuri, për të qëndruar përballë çdokujt me nder e guxim, dhe, Serbia, për këtë e quan sy (sepse, përmes pasurisë sonë mund të jetë ballëhapur në Evropë e gjetkë), vesh, (sepse, do t'i dëgjonte mbështetjet që do i jenin të tjerët, falë kësaj pasurie), zemër, (sepse ajo do të rrahte më normalisht, kur do të kishte me çka të hynte në marrëdhënie ekonomike me të tjerët). Dëshmia më e madhe është Trepça, që, në kreditime, Jugosllavia, e, edhe Serbia, e linte garanci pasurinë e saj. Këto janë arsyet pse Serbia e di çka do, por, ne, ende nuk e kemi zgjidhur këtë enigmë, sepse, shkollat e Beogradit dhe të Athinës, kanë pasë mision të vetin, gjatë gjithë kohëve, njëra për det, e, tjetra për tokë.

Po ta kuptojmë këtë forcë, që e kemi në këtë pjesë të Mesdheut Iliro-shqiptar, (që të tjerët e quajnë Ballkan), si komb, si gjeostrategji e gjeopolitikë, si fuqi ekonomike, atëherë, nuk do të ziheshim në zgripc, por, sidoqoftë, çdo e papritur, do të na e jep mundësinë e bashkimit, ngase, lufta na detyron të veprojmë të gjithë, si komb, dhe, ajo, menjëherë, do t'i shtinte në luftë edhe shtetet që mbajnë të robëruara tokat tona. Nuk do të lejohen lojërat e fundshekullit të kaluar, se, edhe veprimet me bashkëpunëtorë të armikut nuk do të jenë toleruese, sepse, ata janë shkaktarë të një lufte të mundshme, gjë që, unë, kam besim të plotë se nuk do të ndodhë. Faktori ndërkombëtar, nuk do të goxojë të hyjë në këtë aventurë, se do ta përflakë edhe veten!

Këtë e dinë mirë, të gjithë që merren me ne, prandaj, edhe e forcojnë politikisht e materialisht elitën kujdestare, për të qenë në shërbim të misionit sllavoortodoks.

Pyetje: – Me këtë kokë "politike" e "ushtarake", "patriotike" e "kombëtare", të së shkuarës shqiptaro-titiste, ku mund të vëmi? A, pak po na zgjatë amullia, gati dy dekada të plota pas luftës së lavdishme të UÇK-së?

Përgjigje: – Mu këto koka misionarësh na kanë pru në këtë gjendje. Në Shqipërinë londineze patëm shkatërrimin e ushtrisë, në njerëz dhe teknikë ushtarake, nga Sali Berisha dhe sorollopi i tij, sa, në vitin 1998, na paraqiten, bashkë me Lekën (me uniformë mbretërore) në parakalim për ta marrë pushtetin, kur, në Kosovë, bëhej luftë shqiptare për jetë a vdekje. Në Shqipërinë e robëruar krijohet ushtria nga populli, ani se udhëheqësit e dikurshëm, ata që janë gjallë, bashkë me meritat kanë marrë edhe "mandatin" për të folur në emër të saj.

Këtu, kemi të bëjmë me paletaxhinjtë dhe kalemxhinjtë e sotëm, të asaj lufte, që dikur e shanin dhe atë na e kujtojnë vargjet e Nolit për Gurakuqin. Të sharët e asaj kohe harruan dhe sot duhet të shahen për bëmat që i bënë në emër të saj dhe që nuk i lë të mendojnë vet, të veprojnë vet, por, gjithçka mundohen ta arsyetojnë, se ata janë meritorët, që, në realitet, janë meritorët e marrisë.

Kategoria e dytë po ia kalon të parës, sa jam i bindur se zonj. Ollbrajt, e pyet veten, jam apo nuk jam duke vërejtur se këta ia kaluan Rugovës, nëse ai i shau dikur si udhëheqës të UÇK-së, e, sot, këta, po e përbaltin dhe ia kanë humbur dinjitetin shqiptar për liri dhe bashkim.

Amullia do të zgjasë deri sa ta kuptojnë familjet e veteranëve, invalidëve dhe dëshmorëve të kombit, bashkë me intelektualët dhe qytetarët, se, të merituarit po merren nëpër

këmbë dhe në emër të tyre po flasin argatët e misionarëve, që zbatojnë politikën e misionit sllavoortodoks, pra, atë të boshtit kryesor antishqiptar.

Pyetje: – A janë këto pasoja të pacifizmit shqiptaro-titist të LDK-së&Co, apo, janë pasoja të paaftësisë politike e oragnizative të partive që përgatiten, organizuan dhe e bënë luftën për bashkim kombëtar?

Përgjigje: – Pasojat?! Shoku Tafil, ne jemi dëshmitarë okularë të gjithçkaje që ka ndodhur në historinë më të re. Jo vetëm dëshmitarë në kuptimin e vrojtuesit me tejkqyrës, por, edhe aktivë në të gjitha zhvillimet politike e ushtarake të dhjetëvjetëshit të shekullit të kaluar, e, edhe më herët. Në kohën kur duhej bërë përgatitjet e njëmendta ushtarake dhe, kur kishin filluar ato, shumica ishin të frikësuar, se, mos po e nervozojnë Serbinë dhe ajo na bën hi e pluhur për dy orë, nga Nishi. Ta kujtojmë vetëm një intervistë të Ramush Tahirit, kur përmend dy çelësa deposh të armatimit (dyshoj dhe droj, që, si misionar i Ibrahim Rugovës, ka marrë pjesë në shitje), në Fushë Arrëz. Ato, Sali Berisha, përmes Bashkim Gazidedës, i shiti dhe nuk ishte sasi e vogël, bëhej fjalë për 300.000 (treqindmijë) komplete këmbësorie, më modernet në Botë. Këtu, kishte gisht edhe rugovizmi pacifist, përmes emisarëve të vet, kudo në Shqipërinë londineze. Djemtë dhe vajzat tona, shlirimtarët, mbetën me armët që kishin rënë në duart e qytetarëve, në vitin 1997, dhe, shumë pak ka pasur armë të reja. Qeveria e Bukoshit, në njërën anë, dhe rugovizmi, në anën tjetër, të mbështetur nga propaganda e verdhë, arritën t'i koordinojnë veprimet, duke vrarë e burgosur ushtarët e lirisë, dhe, në fund, duke ua ndalur bukën dhe municionin, e, për FARK-un, i cili sorollatej në Laprakë e në Malësi të Tropojës dhe gjithandej Evropës, i pat shndërruar në mercenarë, përmes pagave mujore. Për herë të parë, në luftërat

shlirimtare, ndodhë të paguhen një pjesë e ushtarëve dhe e ushtarakëve, e, pjesa tjetër, që qëllim kishin lirinë dhe bashkimin, të nëpërkëmbët e të poshtërohet kësisoji.

Pra, rugovizmi i bëri këto tri gabime, e para, ndodhi zhdukja e armatimit, e dyta, burgosja dhe vrasja e luftëtarëve të lirisë në fronte lufte dhe e treta, minimi i misionit për shlirim e bashkim kombëtar. Këto tri pasoja ishin qenësore dhe kur këtyre ua shtojmë edhe të katërtën, që e bëri LPK-ja, me moton "vetëm bartësit e taserave të saj mundën për ta udhëhequr luftën", gjë që mundësoi që të bëhej një shpërputhje aritmetiko-gjeometrike, që e mundësoi krijimin i zbrazëtirës për farkistët, sepse, përmasat e hapjes së frontit nuk mund të kontrolloheshin, dhe, erdhën ata që, në fillim e shanin, dhe, së fundmi, e minuan luftën.

Thënë shqip, që të dyja ishin fajtore, e para, sepse e kishte mision për ta ruajtur qetësinë në Mesdheun Iliro-Shqiptar dhe, e dyta, pse nuk mori masa me kohë. Po të mos vepronte dhe ta pushtonte terrenin embema e UÇK-së, që gjeti mbështetje te masat e gjëra, FARK-u, do ta linte popullin në mes të rrugës, siç ndodhi me veprimet e qëllimshme të Tahir Zemës, kur i çarmatosi ushtarët dhe i deportoi nëpër Mal të Zi (aleat i Sllobodan Millosheviçit në luftë), duke e lënë në mëshirën e armikut spitalin ushtarak, me të plagosur. Ky ishte misioni i rugovizmit, sikurse ndodhi në vitin 1993, kur e krijoi ushtrinë dhe e burgosi po vet, për ta frikësuar popullin, se, ne, si parti më e madhe, me Qeveri, me mjete financiare, me strukturë akademike ushtarake, nuk ia dolëm në krye, prandaj, mos u merrni me Serbinë, se ajo, jo vetëm se është më e fortë, por, i ka mundësitë edhe të na burgosë kur të dojë!

Pyetje: – Çfarë çoi te dështimi i betimit të UÇK-së? Kush dhe cili subjekt politik a ushtarak mban përgjegjësi reale para atij betimi të dhënë, të bërë publik menjëherë pas daljes publike të UÇK-së, më 28

Nëntor 1997, në Llaushë të Skënderajt, në varrimin e mësuesit Halit Geci?

Përgjigje: – Janë shumë faktorë që i kanë (para)prirë dështimit të betimit të UÇK-së. Faktori qenësor është, tkurrja e veprimtarisë vetëm në Kosovën administrative, e, jo në Kosovën ku jetonin shqiptarët në ish-Jugosllavi. Për këto dhe shumë gjëra të tjera do të flasë historia. Në asnjë epokë historike, faji nuk mbetët jetim, por, duhet pasur guxim ta pranosh, apo, nëse nuk ka gaditshmëri, duhet ta adresosh. Përgjegjësinë e kanë ata që e themeluan UÇK-në, sepse, ua vunë përpara shlirimtarëve një betim, i cili, pa marrë parasysh rrethanat politike, edhe të mëtejme, nuk guxon të shkelet. Ata që e shkelën, në emër të demokracisë, në emër të pluralizmit, etj. dhe shkuan aq larg, në fillim të veprimit politik, se ishin parti e luftës, ishin shkelësit e parë, duke mos e llogaritur si të parën tkurrjen e territorit. Këta, jo vetëm që e shkelën betimin, jo vetëm e gënjyen elektoratin, gjoja se janë parti e luftës, por, tash, me mjete politike, e rehabilituan djallin e të birin, kryesisht, njerëzit me dosje, që t'ua bënin argatin, me të gjitha mundësitë, me para, me logjistikë dhe me grumbullimin e votave.

Humbja e parë dhe e dytë në zgjedhje parlamentere dhe shumë herë në ato lokale (në disa komuna) ishte çmimi që ia dha qytetari, që ka ndodhur për herë të parë, që fituesi i luftës, t'i humbasë zgjedhjet nga bashkëqytetarët e vet.

Pyetje: – Mos po na përsëritet historia e dhimbshme kombëtare, si në kohën e principatave shqiptare, që e kishin në dorë ta bënin Shqipërinë në kufijtë e saj natyrorë?

Përgjigje: – Kohët kanë ndryshuar edhe në këtë këndvështrim. Principatat kishin qëllimin e tyre, jo vetëm ndaj perandorisë, por, edhe për qytetarët e vet. Princat u munduan ta krijonin mëvetësinë për feudat e tyre, për t'i bërë zap bujkërobërit, në emër të lirisë së sundimit, ndërsa, detyrimet

për otomanët i kryenin, në një masë. Sot, kemi feudë, por këto janë më tepër të karakterit tagrambledhës, për t'i siguruar mjetet e domosdoshme për të bërë politikë. Pra, këto janë të karakterit ekonomok, ndërsa, ato, të karakterit politik, nuk besoj se kanë jetë të gjatë. Kjo, për arsye se kemi ndërgjegjësimin e popullit, në gjithë hapësirën kombëtare, por, në një pozitë më të vështirë qëndrojnë çamët. Ky ndërgjegjësim vërehet te dy probleme që janë ngritur në Kosonë, në atë të Zajednicës dhe të shenjëzimet e kufirit me Malin e Zi. Arsyeja është shumë e thjeshtë, sepse, kanë filluar të gjithë ta shohin "Kanibalin te porta" dhe, domosdo, se, do të veprojnë të gjithë, me përjashtim të nënshkruesve dhe sorollopit të tyre, për t'i mbrojtur këto çështje. Shqiptarët, do t'ia kthejnë Kanibalin, Hazrubalit!

Sot, edhe mundësitë e artikulimit të çështjes kombëtare janë më të mira, e, më të mundshme. Jemi vetëdijesuar për forcën që kemi në rrafshin njerëzor, në rrafshin e popullit, në rrafshin e pasurisë, në rrafshin e përgatitjes shkollore dhe, para së gjithash, në rrafshin e gjeopolitikës dhe tëgjeostrategjisë shtetërore e kombëtare. Jam i sigurt, që, me gjithë këtë potencial që e kemi, nuk do të shkojmë në shkapërderdhjen e energjisë kombëtare, por, në njësimin e saj për bashkëveprim, edhe pse mundohen ta nxjerrin kokën hienat, me misione të sallavoortodokësve, siç është çështja e kombit, çështja e gjuhës, rishkruarja e historisë së Kosovës, që nga Rilindja e jonë kombëtare e deri mësot. Këto janë tema që do t'i nxjerrin në pah shumë lojëra politike, që po bëhen në këtë hapësirë kombëtare dhe do ta kenë efektin e kundërpërgjegjës, shumë të fuqishëm.

Mund të përsëritet përballja, jo e ndarë nga tërësia, por, jo edhe mudësitë e krijimit të principatave!

Pyetje: – E dimë, se Porta e Lartë i armiqësoi ekstremisht dy principatat tona që mund ta bënin

Shqipërinë-SHQIPËRI. Po, partitë tona kush dhe cili shtet "mik" po na i armiqëson kësisoji?

Përgjigje: – Ortodoksizmi sllav dhe pansllav, që, herët, e ka misionin e caktuar për trojet tona, t'i zhbëjë, t'i zbrazë dhe t'i kolonizojë, madje, në mungesë të popullatës sllave përreth nesh, janë të gatshëm të sjellin edhe nga Karpatet, vetëm e vetëm të mos frymojnë shqiptarët në këtë nënqiell këtë nënqiell autokton e gjeoautokton. Kjo, paksa, duket e çuditshme si shprehje, por, ne kemi përjetuar situata të tilla. Miqtë tanë, e kanë në ndërdije këtë, sepse, Leo Freundlich u ka treguar që në vitin 1913, për politikën e re serbe, në "Golgota shqiptare". Ua kam dërguar të gjitha përfaqësive të zyrave informative, edhe Soren Jessen Petersenit, e, përmes tij, Kofi Ananit, bashkangjitur edhe një letër dëshmi, për po të njëjtën politikë serbe të vitit 2005, e cila, sa vjen e po konsolidohet, gjithnjë, për fat tonin të keq, me mbështetjen ndërkombëtare.

Shtetet mike e dinë këtë, sepse, shërbimet sekrete të tyre nuk janë vetëm sot në trojet tona. Ata kanë edhe departamente që e kanë studiuar, madje edhe sot merren me studimin e problemit shqiptar e të sllavoortodoksizmit karpatian. Mos të flasim për shtetet me të cilët jemi në zgripc të konfliktit, jo me dashjen tonë, por, jemi të detyruar ta mbrojmë qenien tonë dhe tokën tonë, si në mbarim të shekullit të kaluar, po e kërkoi nevoja.

Nuk është edhe në interesin e Fuqive të Mëdha të ketë një shtet të konsoliduar shqiptar në këtë pjesë të Evropës, se, nuk do të luhej loja e aeropagut në mes të dy supërfuqive, sepse, jemi ndër katër kombe me ndikim në Evropën lindore. Për të na copëtuar në gjashtë shtete kanë qenë edhe miqtë tanë dhe këtë e ka dëshmuar Edward Grey dhe Woodrow Villsoni. Vetëm të marrët nuk e kuptojnë, sikur nuk kanë dashur ta kuptojnë, se liria nuk vjen në pjatë, pra, edhe bërja e

Shqipërisë-Shqipëri nuk vjen nga dëshira e askujt, por nga vet puna e jonë.

Derisa kemi programe qytetare, në gjithë hapësirën kombëtare, që garojnë për marrje pushteti përbrenda territorit veprues, ne, as që duhet menduar se mund të ecim përpara. Fryma e bashkimit duhet të jetë në dukje, në të gjitha kuvendet ku i kanë shqiptarët kuvendarët e vet. Kjo nuk po ndodhë, se ende është e fuqishme politika e Sali Berishës andej kufirit dhe e Ibrahim Rugovës këtij kufirit shqiptaro-shqiptar. Edhe para lufte e kam thënë, kur është i robëruar një komb, nuk ka nevojë për pluralizëm, por, në fund të fundit, ata që kanë dëshirë t'i plotësojnë apetitet e pushtetarëve (në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginë), madje, edhe në Kosovë, le ta luajnë lojën me ta, por, zëri i arsyes dhe situata e krijuar kërkon të orientohen kah kushtrimi për shtet–komb. Shembull po e marrim vetëm Malin e Zi, shqiptarët janë shtatë përqind, sipas qeverisë malazeze, dhe mëzi arritën ta kenë një deputet. Në Kosovë, serbët, nuk e kanë as një përqind dhe kushtëzojnë vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në nivel ambasadorësh, që ata të njihen kategori kushtetute, se vetëm ashtu mund ta kenë një kuvendar.

Pyetje: – Krahut të luftës për liri e për Shqipëri, shqiptaro-titistët&Co ia kanë futur brirët nga të gjitha anët. Çfarë pritet dhe çfarë duhet të ndodhë në skenën tonë kombëtare, që të këndellemi dhe ta bëjmë Atdheun me kufijtë natyrorë që ka?

Përgjigje: – Të cilës luftë? Luftës që bëjnë në vazhdim veteranët e rezistencës kombëtare, për ta emancipuar popullin dhe për ta përgatitur për një marsh drejt bashkimit, apo luftës që ka zhvilluar UÇK-ja? Nëse është fjala për të dytën, me mbarimin e saj, mbaron edhe krahu i luftës. Po të ishte vazhdim i luftës së njëmendt politika, se në politikë janë të njohura, lufta vazhdim i politikës, por edhe politika vazhdim i

luftës, së pari, nuk do të kishin lejuar të nëpërkëmbën bashkëluftëtarët e tyre, nuk do të mbeteshin në mëshirën e fatit të jetës, nuk do të vonohej merita e akëcilit në luftë, nuk do të lejohej të bëhet pazar me gjakun e dëshmorëve, e shumë gjëra të tjera, të pamira.

Titistët e kanë pjellë rugovizmin dhe, për këtë kategori, kam folur më lart. Këta kanë marrë për mision zhbërjen e rezistencës kombëtare dhe nuk u është dashur të përpiqen shumë, se, i kanë pasur dosjet dhe dikënd nuk e kanë lënë të eci me ta, se, kanë dyshuar pse janë me ta, e dikë e kanë përcjellë për të mësuar, pse nuk është me ta. Shembulli i parë është Ukshin Hoti dhe Bislim Elshani, të cilët, edhe pse kishin fituar për kuvendin e parë të LDK-së, nuk i lejuan të shkojnë. Shembulli i dytë jam unë, kur në vitin 1995, një polic më afrohet dhe më jep një akt zyrtar nga sindikata e policisë (rugoviste), në të cilin figuronin tre policë për përcjellje të aktivitetit tim, që nga gjysma e dytë e vitit 1990. Në mesin e tyre edhe ai vetë, i cili, edhe ma dha dorëheqjen që e kishte bërë, pas tre muaj përcjelljeje. Shembuj të tillë, me siguri, ka shumë. Mu për këtë, unë, nuk jam i mllefosur te kjo kategori dhe me gjithë forcën i jam kundëvu kësaj filozofie vrastare për kombin. Por, me ata të cilët edhe kishim një bashkëudhtim, me shumicën prej tyre kam bashkëvepruar në kohë dhe rrethana të ndryshme dhe, në fund, u desht për t'i ndarë rrugët politike. Motoja, ne jemi krahu i luftës, për ta përdorë atë për shumë fëlliqësira që i kanë bërë, jo ish-ushtarëve të vet, sa çështjes kombëtare, që, edhe më shumë janë zhytur në batakun e tradhtisë.

Lufta nuk mbin në kopsht, sikurse trandofili, por, ajo, duhet kultivuar dhe duhet ta ushqesh vazhdimisht me fakte historike, për bindjen e gjeneratave, se, ende nuk e kemi përfunduar atë, arsyet pse kjo nuk është e përfunduar dhe mënyrën se si duhet përfunduar. Këta që janë të rreshtuar në

këtë front dhe ata që do ta kuptojnë drejtë këtë mesazh, mund të quhen krahu që përgatitë luftën, nuk merret gjithnjë vetëm si përdorim arme, për çështje kombëtare, që, para se të na pranojë Evropa, ne, të takohemi në Bruksel, si komb, e, për këtë kemi kohë, të paktën, edhe shtatë vjetë.

Duhet ta përmbysim gjithë skenën politike dhe ta krijojmë krahun e vetëdijesuar për çështje kombëtare dhe as që duhet lodhur se si do të gjenden të dy krahët politikë në trojet shqiptare, sepse, që të gjithë, me përjashtime, e kanë ngulfatur krenarinë e kombit, e kanë zhbërë angazhimin e veprimit kombëtar, i kanë njollosur veprimtarët e çështjes kombëtare, duke menduar se paraja dhe pozita krijojnë personalitete, përkundrazi, dhe, i japin të drejtë vetes, sikur janë baballarë të kombit, në krye me Sali Protopapën e titorugovistët.

Nuk duhet kthyer kokën prapa, për të parë, se, prapa shkurreve është miu apo lepuri, se përballë e kemi një qen, sado i zhubrosur që është, në këtë huti, do të na mundë përfundimsht në histori. Humbja, nuk guxon të ndodhë.

Pyetje: – Serbia po e rrethon kufirin me Kosovën shqiptare me armatim të të gjitha llojeve, kuptohet, me ndihmën e nënës së saj të madhe, Rusisë së Putinit; çfarë duhet të bëjmë ne që të jemi dalëzotësit e vërtetë të Atdheut tonë?

Përgjigje: – Ky armatim, në trojet tona dhe përreth nesh, nga pala serbe, është më tepër një manovër ushtarake, një gogol, që tash i takon së kaluarës, sepse, nuk do të vjen në shprehje ta përdorë. Jo pse ne i dhimbsemi, por, për shkak të pasojave që do t'i ketë vet. Ne, edhe para lufte, pothuaj, të njëjtin arsenal e kishim përbrenda. E kam thenë edhe më lart, se, Evropa nuk është e gatshme ta lejojë një luftë të armatosur në gjiun e saj, Këtë e di edhe Serbia, por, duhet ta dinë edhe shqiptarët. Këtë rrethim me fabrika, poligone dhe kazerma,

politikanët tanë e shfrytëzojnë për të na frikësuar dhe na e paraqesin gogolin Serbi. Ne nuk jemi më shpërgej, duke dëgjuar ninulla, se këtë e kemi tejkaluar, por, tash, jemi në kohën kur duhet vepruar në planin kombëtar dhe këtu hynë edhe investimet për forcimin e ushtrisë. Viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, Serbia ishte një pulë e nuktë dhe këtë e mbanin larot e tipit të Mahmut Bakallit, me një "liberalizim", por, të mos harrojmë se edhe ky, me politikën e tij, e "zbuloi" shtabin e irridentës në Krye me Adem Demaçin, sikurse dikur Lazar Mojsovi, me 1989, që e "zbuloi" shtabin e armatosur të irridentës. Çfarë dallimi ka në mes këtyre dyve?!

Duhet punuar, e thashë edhe më lart, për ta ndërgjegjësuar kombin, ndër ato që duhet spjeguar është edhe kjo manovër serbe, për ta zhveshur plotësisht propagandën për gogolin, që na e transmetojnë liderët aktualë të politikës shqiptare. Punët duhet koordinuar dhe duhet t'i kthehemi Tiranës, si shkollë kombëtare, duke lënë menjanë Beogradin, Athinën, besa edhe Brukselin, se, ka kohë kur i kthehemi asaj.

Pyetje: – Me politikanët që kemi në pushtet (andej e këtej kufirit), populli shqiptar është shumë i pakënaqur, po njësoj i pakënaqur është edhe me opozitën. Cila mund të jetë përgjigjja e tyre rrethanave ekzistuese të kohës, kur kemi parasysh forcën ushtarake të apetitorëve pushtues të trojeve tona etnike?

Përgjigje: – Me të vërtetë, jemi në rrethana shumë të vështira, sepse, misionet e huaja e kanë krijuar shtratin në trojet tona dhe po shihet se po përgatitet edhe shtrati i Prokrustit. Por, edhe gjendja sociale është e mjerë, dy faktorë shumë domethënës, nëse dimë t'i shfrytëzojmë në shërbim të kombit.

Ne, shqiptarët, nuk kemi opozitë. Nuk kemi opozitë, sepse, partitë që kanë ekzistuar, luftojnë për t'i ndërtuar

pozicionet në pushtet. Por, është shumë me rëndësi se populli, në masë të madhe, është opozitë, treguesi më i mirë janë zgjedhjet anekënd trojeve shqiptare, që, në masën deri në 55% nuk u përgjigjen thirrjeve shterruese të liderëve. Shikuar së mbari, për ta bërë një analizë të thuktë, shkencore dhe politike, merrini parametrat e viteve të nëntëdhjeta dhe të sotmet, shihet dukshëm rënia e votuesve. Kjo e ngacmon faktorin ndërkombëtar, sa edhe ai përfshihet në fushata elektorale, paraprake apo edhe të drejtpërdrejta. A nuk është edhe ky një tregues, bukur i fuqishëm, se misioni i të gjithëve është shpëlarja e trurit, që shqiptarët të mos mendojnë njësoj, të mos veprojnë njësojë, të mos e shikojnë njësoj të ardhmen, por, në vend të pasqyrës, institucionalistëve ua kanë dhënë syrin e kalit, për t'i shikuar veprimtarët e rezistencës kombëtare.

Ka përpjekje për një opozitë në Kosovë, por, që nuk e ka të qartë vizionin për çështjen kombëtare. Vizioni kombëtar ka shumë parametra, që nga thithja e energjisë mendore, e deri te ajo vepruese. Ekziston frika te këta, qoftë për të dalë nga gëzhoja e krijuar, qoftë për të qenë të hapur, qoftë për ta dalluar potencialin mendor kombëtar dhe kjo e bën të varfër dhe të pafuqishme në luftën titanike me të gjithë këta mekanizma. Opozita, ajo çfarë është, i ka lëvizur pakës gurët nga vendi, duhet pranuar rezultatet, por, sigurisht, ju shoku Tafil, keni menduar për një opozitë (tok me Tiranën shqiptare) që do ta përmbyste klasën politike, për ta marrë në duar flakadanin e ecjes përpara, deri në kryerjen e misionit kombëtar.

Opozitës, vetëm po ia kujtoj (nëse dikush prej tyre e lexon këtë intervistë), blerjen e trurit prej hebrenjve, ndërsa, këta e kanë falas trurin e shqiptarëve dhe nuk dinë ta shfrytëzojnë, ky është mjerim dhe largim nga misioni, nëse ia kanë caktuar vetes misionin e çështjes kombëtare. Kjo, thjesht, se akëcili

mendimtar, nëse nuk ka teserë partie, nuk e vlen të merret mendimi i tyre, si dikur te themeluesit e UÇK-së!

Pyetje: – Ndërkombëtarët, këtu, sa nuk e njohin dhe sa nuk duan ta njohin realitetin e hidhtësisë së shqiptarëve me trojet e tyre etnike, duke qenë rast unik në botë trojet e një populli dhe qenia e tij njerëzore ndarë në gjashtë shtete antishqiptare. Çfarë duhet të bëjë BE dhe bota, me në krye SHBA, që t'i përmirësojnë gabimet e veta në kurriz të Shqipërisë dhe në kurriz të shqiptarëve?

Përgjigje: – Një gjë duhet ta kemi parasysh, në relacion me BE-në. Ajo është e vetëdijshme dhe e ka të njohur gjendjen e shqiptarëve, jo vetëm sot, por, në vazhdimësi, që nga Kongresi i Berlinit (1878). Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka arritur që edhe Bizmarkun ta detyrojë ta ndryshojë mendimin dhe ta pranojë realitetin shqiptar. Shqipëria londineze, që nga viti 1945, ia ka bërë të ditur Evropës problemin kombëtar, e, këtë e ka ngritur në nivelin më të lartë, gjatë periudhës 1972-1974, në Helsinki, kur nuk pranoi t'i nënshkruajë kufijtë me fqinjët. Po këtë, e ka bërë të njohur në vitin 1990, në OKB, edhe Ramiz Alia. Siç del nga këto, BE-ja është në rrjedhë të gjithë ecjes së problemit shqiptar, prandaj, edhe e mbështetë misionin sllavoortodoks. Ajo, edhe e stimulon faktorin turk, në shumë projekte të saj, në trojet shqiptare, madje, duke i dhënë edhe përparësi, sepse, është e sigurtë se ajo po e luan rolin shumë bukur, për pasivizimin e shqiptarëve, në njërën anë, dhe, shkatërrimin e ekonomisë shqiptare, në anën tjetër.

BE-ja dëgjon dhe kupton, vetëm kur ne ta ngrisim çështjen tonë në nivel të përgjegjësive tona, në kohë dhe hapësirë. Kishte demonstrata, kishte burgosje, vrasje dhe shumë fenomene tjera nga pushteti i Beogradit, i Shkupit e i Podgoricës, por, ajo u mor me ne vetëm kur buqitën armët e luftëtarëve të lirisë – të UÇK-së.

Ne, mbajmë përgjegjësi për mundësitë e manipulimit të BE-së me ne. Pushtetarët, nuk ka qenë dashtë ta pranojnë asnjë misionar të saj, kur dërgon pjesëtarë të shteteve që ia bëjnë argatin Serbisë pushtuese dhe gjenosidale e etnocidale, në të gjitha planet, siç janë rusët, grekët, spanjollët, sllovakët, etj. Sikur ta kishin ndërmarrë një veprim të tillë, BE-ja, ndryshe do të kishte menduar e vepruar në relacion me ne. Kur ajo sheh që heshtet rasti i Ulqinit, i vetmi vendim i marrur në Kongresin e Londrës, se, pas 99 vitesh i kthehet Shqipërisë, e, shqiptarët nuk e kanë bërë asnjë hap në këtë drejtim, prandaj, BE dhe Brukseli, këtë na e kthen si bumerang gjithë kombit. Ne, nuk duhet të befasohemi me qëndrimet e saj dhe të Brukselit ndaj nesh, sepse, ajo sillet me ne duke na injoruar pafundësisht, siç vepron edhe Brukseli, duke u tallur me injorancën e pushtetarëve, duke u tallur me paaftësitë e pushtetarëve, duke u tallur me bërien e politikave dhe mu për këtë kërkon që edhe më tej ta përfillim mendimin e saj (tij) prej mentori. Duke i pasur të gjitha këto parasysh, BE-ja, ka aritur që problemin e serbëve ta ngritë në nivel të Brukselit, e, të bisedohet për probleme tokësore e qytetare të Kosovës, e, jo ta detyrojë Serbinë, që të ulet, dhe të bisedohet, siç ndodhë rëndomë me shtete të dala nga lufta.

Kemi harruar se mentorët tanë ishin rilindasit, që vështirë se njeriu ta gjejë ndonjë komb me kaq program të qartë dhe të mundshëm për përmbushje.

Gjithë këtë bashkëbisedim që e zhvilluam, qenësorja ishte se ne nuk jemi duke vepruar në kuadër të mundësive, në kuadër të përceptimeve të problemeve që na dalin përpara, në kuadër të forcës mobilizuese kombëtare, por, politikën e kemi bërë pronë feudësh dhe sillemi në rrethin e saj vicioz. Këtë, duhet, sa më shpejtë, ta ngritim në nivelin e rrethit të Arkimedit, fillimin e dimë, duhet të lëvizim, duke u shtrirë në hapësirën tonë kombëtare dhe kur t'i arrijmë cepat e atdheut,

siç i kishim arritur më 1990, mund të bëhemi partnerë të BE-së për bisedime, në rrafshin kombëtar dhe nga loja do të binin shtete artificiale, të cilat, fatkeqësisht, ende i mbajnë gjallë shqitarët, Maqedonia dhe Mali i Zi. Beteja ndaj Serbisë është shumë e lehtë, kur të fillojnë të parashtrohen argumentet, në planin kombëtar, territorial, fetar, etj.

Pyetje: – Si po ecën politika dhe diplomacia shqiptare, karshi bëries së vetvetes, në kohë dhe rrethana të kështuzme?

Përgjigje: – Duhet ndarë diplomacinë e Shqipërisë londineze nga kjo e Kosovës, sepse, nuk janë në harmoni, ose në bashkëveprim njëra me tjetrën, jo sot, por, kjo është shndërruar në fenomen, gjatë viteve të nëntëdhjeta e këtej. Kjo është e qëllimshme, sepse Bukseli e kushtëzon diplomacinë e Kosovës për të ecur ndaras nga ajo e Shqipërisë londineze (e, kësaj ideje antishqiptare i ka paraprirë rugovizmi dhe berishizmi), gjë që nuk duhet të ndodhë më, me asnjë kusht a kushtëzim të BE-së, etj.

Diplomacia e Shqipërisë londineze ka filluar të konsolidohet, sepse viteve të nëtëdhjeta ajo ka qenë diplomaci kursantësh në Indonezi, me nga gjashtë muaj, ndërsa, shtetet tjera kanë pasur diplomaci profesionale. Llogarite se sa ka humbur diplomacia e jonë në rafshin kombëtar ato vite, dhe, e kemi shumë të vështirë ta marrim hapin, në hapësirë e kohë.

Kjo ndarje e diplomacisë na kushton shtrejtë dhe këtë tagër e paguan i gjithë kombi, se e kemi edhe segmentin tjetër diplomatik nga Maqedonia, ku janë të përfshirë edhe diplomatë shqiptarë, të cilët, në asnjë moment, nuk flasin dhe nuk veprojnë shqip (në kuptimin politik e diplomatik).

Tirana e ka për detyrë dhe obligim Kushtetues të depërtojë në diplomacinë e vendeve të rajonit, Evropës, Azisë dhe përtej Atlantikut, për ta trajtuar çështjen shqiptare në vija të drejta dhe për ta shkurtuar rrugën e realizimit të saj.

Nuk do të thotë diplomaci, kur Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë, i thotë zv. Ministrit të po asaj Ministrie të Kosovës, se Turqia është Kosovë dhe Kosova është Turqi dhe neve na servohet si lajm shumë me peshë! Kjo është diplomaci folklorike, për të cilën nuk kemi nevojë as të dëgjojmë, e, të ngjajshme kemi pothuaj nga të gjitha shtetet. Se sa është efikase kjo diplomaci, duhet parë realitetin në terren, kur pjesa dërrmuese e shteteve që e kanë njohur Kosovën, pak sosh e kalojnë formalitetin.

Nëse nuk vetëdijesohen institucionalistët, për t'i ndarë detyrat me përgjegjësi kombëtare, për të paraqitur gjendjen reale me akcilin shtet, për ta plotësuar njëra-tjetrën me materiale të domosdoshme, për ta plotësuar stafin e vet diplomatik me profesionalizëm, edhe më tej do të kemi probleme në artikulimin e gjërave që duhet trajtuar si parësore, të dorës së dytë, e kështu me radhe, në njërën anë, e, në anën tjetër, të dalim qesharak para shteteve tjera, me dikush thumbit e dikush patkoit.

Diplomacia e shqiptarëve, jashtë Shqipërisë londineze, duhet konsoliduar dhe bashkëvepruar me Tiranën në radhë të parë, sepse, sikurse dora e jote nuk të kruan asnjë dorë tjetër.

Pyetje: – Pyetje mund të bëjmë pa fund dhe, natyrisht, se, nuk do mungojnë as përgjigjet, por, nëse nuk ju kemi pyetur për diçka që duhet ta thoni, thujeni për lexuesit tanë. Apo, mjafton që porosi për të gjithë të jenë intervistat e imagjinuara me amanetin bazik: bëjeni Shqipërinë – Shqipëri?

Përgjigje: – Shoku Tafil, u mundova të përgjigjem në pyetjet tuaja me sinqeritet, jo për ju, por për lexuesin dhe në kuadër të njohurive që kam.

E vërtetë është se përmes intervistave të imagjinuara, jam munduar t'i kapë kohët dhe njerëzit që e kanë bërë historinë tonë kombëtare. Ata na e kanë lënë një mesazh të

forte, të mbarë dhe të mirë, që, ne, ende nuk po mundemi, të paktën, politikisht, ta trajtojmë në një formacion më të gjerë dhe t'ia lëmë gjeneratës së re, që ta zbatojë. Ju dhe unë kemi lexuar për platforma kombëtare nga individë, nuk dua t'i nënçmoj aftësitë e tyre, por, një gjë duhet pasur parasyshë, secili që hyn në këtë lojë, gabon, platformat duhet të krijohen nga një grup bukur i madh njerëzish, me pedigre kombëtare, me aftësi profesionale nga të gjitha fushat e jetës, duke ua përshtatur rrethanave dhe kohës për zbatim. Këta, e kanë bërë për kapuç të madh, për të thënë se unë jam dikushi. Kemi fusha të caktuara ku duhet treguar veten, por, në radhë të parë, duhet pasur guxim dhe logjikë të shëndoshë, në kohën kur ndërmerr veprime.

Në këto intervista, jam munduar t'i përfshijë: burrështetasit, shkrimtarët, veprimtarët, ushtarakët, të cilët kanë lënë emra në historinë tonë kombëtare, dhe, për mua, veprimtaria e tyre politike është alfabeti politik i shqiptarizmës, që na mungon shumë, sot. Ata, njëri pas tjetrit, e vunë nga një shkronjë politike në themelet tona kombëtare, që, ne, sot, përtojmë, nuk dimë, apo nuk duam ta pranojmë, që ta vazhdojmë punën e lënë përgjysmë, për shkak të kohës. Ata na e caktuan hartën kombëtare dhe shtetin shqiptar e vunë në binarë të vet, ndërsa, ne, veç po shkojmë duke e shqyer atë e duke e minuar shtetin shqiptar, që, edhe është rreziku më i madh që na ka ndodhur dhe po na ndodhë para syve tanë.

Bëjeni Shqipërinë - Shqipëri, a ka mesazh më të fuqishëm? Ata, tërë jetën ia kushtuan kësaj motoje dhe ne nuk i përfillim qëndrimet e tyre teorike e praktike, por, më shumë na joshin historitë e huaja, liderët e huaj, dhe, fitohet përshtypja sikur ka humbur sensi për të qëndruar në këmbët tona, në truallin tonë, si Anteu.

Të gjithë veprimtarët e çështjes kombëtare, duhet t'u drejtohen atyre, sikurse ne dikur, për ta mësuar, nga përvojat

e tyre, veprimtarinë e tyre, për të ditur se si ndahet shapi prej sheqeri, jo vetëm përbrenda kombit, por, edhe në relacion me ndërkombëtarët. Kjo është shkolla shqipe, me bazament në Tiranë, sepse, hë për hë, Tirana është edhe Kryeqyteti i kombit.

Në këto intrervista të imagjinuara, më vjen keq që nuk kam mundur t'i përfshijë të gjithë meritorët, emra, që, kur kanë vdekur, i ka vajtuar i gjithë kombi, por, kjo ishte mundësia ime, hë për hë.

Shoku Afrim, faleminderit!

Faleminderit edhe prej jush, shoku Tafil!

Tiranë, Tetor 2016

Për portalin Pashtriku, Intervistoi: Tafil DURAKU